



BASHKIMI EVROPIAN
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



PËRMBLEDHJE E BAZËS LIGJORE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

*MATERIAL MBËSHTETES PËR
SHKOLLËN E INTEGRIMIT EVROPIAN*

PËRMBLEDHJA E BAZËS LIGJORE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

DOKUMENT JO ZYRTAR

Botues: Friedrich-Ebert Stiftung
Office Tirana
Rr. Kajo Karafili
Nd-14, Hyrja 2, Kati 1
Kutia Postare 1418 Tiranë,
Albania
www.fes-tirana.org

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht të Fondacionit Friedrich-Ebert apo të donatorëve.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

PËRMBLEDHJE E BAZËS LIGJORE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

*MATERIAL MBËSHTETES PËRSHKOLLËN E
INTEGRIMIT EVROPIAN*





PERMBAJTJA:

DY FJALË PËR BOTIMIN	7
LIGJI NR. 9590, DATË 27.7.2006 “PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETEVE EVROPIANE E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE"	8
VENDIM NR. 179, DATË 22.02.2006 “PËR KRIJIMIN E NJËSIVE TË INTEGRIMIT EVROPIAN NË MINISTRITË E LINJËS”	9
VENDIM NR.17, DATË 7.01.2009 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.179, DATË 22.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E NJËSIVE TË INTEGRIMIT EVROPIAN NË MINISTRITË E LINJËS"	11
VENDIM NR. 577, DATË 24.6.2015 “PËR NGRITJEN E RRJETIT TË NJËSIVE TË INTEGRIMIT EVROPIAN DHE RRJETIT TË NJËSIVE TË HARTIMIT TË LEGJISLACIONIT NË MINISTRITË E LINJËS”	17
LIGJ NR. 15/2015 PËR ROLIN E KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN	20
VENDIM I BYROSË SË KUVENDIT NR. 67, DATË 04.05.2016 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EVROPIAN”	29
VENDIM NR. 500, DATË 13.9.2017 “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME”	38
VENDIM NR. 749, DATË 19.12.2018 “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SHTETËRORE, PËRGJEGJËSE PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE DHE LIDHJEN E TRAKTATIT TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”	40
URDHËR KRYEMINISTRI NR. 93, DATË 20/05/2019 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TEKNIK TË GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS”	46
URDHËR KRYEMINISTRI NR. 94, DATË 20/5/2019 “PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN”	48
URDHËR KRYEMINISTRI NR.113, DATË 30/08/2019 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PLATFORMËS SË PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN”.....	75
REZOLUTË E KUVENDIT DATË 03.10.2019 “PËR MBËSHTETJEN E PROCESIT TË FILLIMIT TË BISEDIMEVE PËR ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN.”	78
VENDIM NR. 91, DATË 09.02.2022 “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2022–2024”	81
VENDIM NR. 422, DATË 6.5.2020 PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN.....	82
VENDIM NR. 421, DATË 27.5.2020 PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS PËR ANËTARËT DHE SUBJEKTET JOANËTARE TË GRUPIT NEGOCIATOR PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË	

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN, SI DHE TË FUNKSIONARËVE TË KABINETIT TË KRYENEGOCIATORIT.....	89
REZOLUTË E KUVENDIT DATË 24.09.2020 PËR HAPJEN E NEGOCIATAVE PËR ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN DHE PLANIN E MASAVE PËR PËRMBUSHJEN E PËRPARËSIVE TË PËRCAKTUARA NGA KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN	90
VENDIM NR.91, DATË 9.2.2022 “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2022–2024”	93
VENDIM NR. 520, DATË 29.7.2022 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”, TË NDRYSHUAR”	94

DY FJALË PËR BOTIMIN

Të nderuar lexues,

Ky botim është munduar të përmbledhë disa nga aktet normative të cilat rregullojnë kuadrin ligjor dhe institucional koordinues në procesin e integritit evropian.

Kjo nuk është një përmbledhje ezauruese e kuadrit të gjerë rregullues në Shqipëri.

Basa ligjore e përzgjedhur për këtë botim është ndihmuese për Shkollën e Integritit Evropian, të organizuar nga Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian, Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe Fondacionin “Friedrich Ebert”.



Ligji Nr. 9590, datë 27.7.2006

“PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETEVE EVROPIANE E SHTETEVE TË
TYRE ANËTARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Shpallur me dekretin nr .5010, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë¹

President
ALFRED MOISIU

¹Versionin e plotë të “Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare” e gjeni në faqen:

<http://dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/Marreveshja%20e%20Stabilizim%20Asociimit%20BE-Shqiperi.pdf>

VENDIM

Nr. 179, datë 22.02.2006

“PËR KRIJIMIN E NJËSIVE TË INTEGRIMIT EVROPIAN NË MINISTRITË E LINJËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafëve i parë dhe i dytë të nenit 4 të Ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e njësive të integrimit evropian, në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
2. Njësitë e integrimit evropian të bashkërendojnë dhe të mbështesin punën e institucioneve respektive, për fushat e përqendruara në elementet kryesore të acquis communautaire, në zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sipas përcaktimit të aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Numri i nëpunësve të këtyre njësive të përcaktohet më varësi të çështjeve dhe nevojave të secilit institucion, të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi.
4. Nëpunësit e njësisë së integrimit evropian emërohen sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, në përputhje me kriteret e parashikuara në aneksin II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Njësia e integrimit evropian është përgjegjëse për:
 - a) bashkërendimin e brendshëm institucional, sigurimin e lidhjes së drejtëpërdrejtë dhe bashkërendimin e punës me Ministrinë e Integrimit dhe me ministritë e tjera të linjës, për angazhimet e marra nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit;
 - b) bashkërendimin e brendshëm institucional dhe bashkërendimin e punës me Ministrinë e Integrimit dhe me ministritë e tjera të linjës, për procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me acquis communautaire dhe për raportimin e akteve normative, që adaptojnë acquis communautaire, në kuadër të programit TAIEX;
 - c) bashkërendimin e brendshëm institucional për përgatitjen e raporteve për procesin e integrimit evropian;
 - ç) monitorimin dhe raportimin brenda ministrisë për çështje të integrimit evropian;

- d) shpërndarjen e të dhënave për procesin e integrimit evropian ndërmjet ministrisë ku bën pjesë, Ministrisë së Integrimit dhe njërive të integrimit evropian në ministritë e tjera të linjës;
- dh) vlerësimin e veprimtarisë së institucionit në raport me ecurinë e procesit të integrimit evropian, propozimin e mekanizmave funksionalë për lehtësimin e zbatimit të reformave sektoriale, nga zbatimi i marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përmes procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire*, dhe ngritjes së kapaciteteve administrative;
- e) rekomandimin e përparësive, shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe planifikimin e veprimtarive për mbështetjen institucionale të procesit të integrimit evropian.
6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxhetet vjetore, të parashikuara për këto ministri.
 7. Ngarkohen ministritë e përmendura në pikën 1, që, brenda muajit prill 2006, të paraqesin, për miratim të Kryeministri, propozimet për implementimin e këtyre njërive në strukturat e tyre.
 8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Integrimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

VENDIM

Nr.17, datë 7.01.2009

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.179, DATË 22.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E NJËSIVE TË INTEGRIMIT EVROPIAN NË MINISTRITË E LINJËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafëve të parë e të dytë, të nenit 4 të Ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.179, datë 22.2.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Krijimin e njësive të integrimit evropian, si struktura të veçanta, në nivel drejtorie, në përbërje të të gjitha ministrive, me përjashtim të Ministrisë së Integrimit. Institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, krijojnë njësitë e integrimit evropian, në përputhje me nevojat e tyre."

2. Në fund të pikës 3 shtohen fjalët: "...por jo më pak se tre nëpunës."

3. Pas shkronjës "e" të pikës 5 shtohen shkronjat "ë" e "f", me këtë përmbajtje:

"ë) bashkërendimin dhe monitorimin e programimit të ndihmës komunitare, që mund të ofrohet, në kuadër të integrimit evropian;

f) mbështetjen teknike të mbledhjeve të grupeve të punës të përhershme, sipas kapitujve të *acquis communautaire-GPKA*;"

4. Në pikën 6, fjalët "...për këto ministri..." zëvendësohen me "... për institucionet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi..."

5. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, të cilat nuk i kanë implementuar, brenda strukturës së tyre, këto njësi të integrimit, të paraqesin, për miratim, te Kryeministri, propozimet për ngritjen e këtyre njësive, brenda muajit janar 2009."

6. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

"8. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi dhe Ministria e Integrimit për zbatimin e këtij vendimi."

7. Anekset I e II, që i bashkëlidhen vendimit nr.179, datë 22.2.2006 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me anekset I e II, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI I

FUSHAT SEKTORIALE QË DO TË KOORDINOJNË RESPEKTIVISHT NGA NJËSITË E INTEGRIMIT EVROPIAN

Institucioni, Fushat

Të gjitha ministrinë: Lufta kundër korrupsionit

Ministria e Drejtësisë

- Sistemi gjyqësor;
- Përmirësimi i sistemit të burgjeve;
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit përmbarrimor;
- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve;
- Sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Kthimi dhe kompensimi i pronave;
- Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar;
- Njohja reciproke e kualifikimeve për profesionet e lira.

Ministria e Jashtme

- Politika e vizave, politika e jashtme, minoritetet

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

- Siguria ushqimore;
- Shërbimet veterinarë;
- Prodhimi bimor;
- Agropërpunimi dhe marketingu;
- Blegtoaria;
- Mbrojtjabimëve;
- Zhvillimi rural;
- Reforma e tokës, tregu, administrimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e tokës;
- Plehrat kimike/kimikatet-MBUMK (është përgjegjëse për kimikate si pesticide).

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

- Ndihma shtetërore;
- Të drejtat e pronësisë industriale;
- Marrëveshje të tregtisë së lirë;
- Andidumping;
- Standardizimi dhe certifikimi;
- Akreditimi;
- Metrologjia ligjore dhe parapaketimet;
- Direktivat e përafrimit teknik (Në Approach)
- Pajisjet elektrike;
- Enët me presion;

- Lodrat;
- Përputhshmëria elektromagnetike;
- Makineritë;
- Pajisjet e mbrojtjes personale;
- Pajisje me gaz;

Mbi kërkesat për efikasitetin e bojlerëve të rinj që punojnë me lëndë djegëse dhe të gazta; Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të përdorshme në atmosfera potencialisht shpërthyes;

Ashensorët;

- Paketimi i mbetjeve;
- Instalime kabllore për transport personash;
- Eficienca energjetike e pajisjeve frigoriferike, ndriçimit fluoreshent dhe paketimi i pajisjeve elektroshtëpiake;
- Direktivat e përafrimit të vjetër;
- Qelqi;
- Tekstilet
- Druri
- Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut;
- Liria e vendosjes dhe për të ofruar shërbime;
- Legjislacioni për shoqëritë tregtare;
- Zhvillimi rajonal;
- Energjia;

Sektori i energjisë;

- Sektori i hidrokarbureve;
- Politikat industriale;

Politikat industriale; Sektori i minierave;

- SME-të, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- Kimikatet METE (është përgjegjëse për kimikatet si lëndë e parë për industrinë duke përfshirë import-eksportin).

Ministria e Financave

- Doganat;
- Tatimet;
- Menaxhimi i financave publike;
- Parandalimi i pastrimit të parave;

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Legjislacioni horizontal për mjedisin;

- Cilësia e ajrit;
- Menaxhimi i mbetjeve;
- Administrimi i burimeve ujore;

- Parandalimi i ndotjes së ujit;
- Mbrojtja e natyrës;
- Ndotja dhe rreziqet industriale;
- Kimikatet-MMPAU (është përgjegjëse për kimikatet si mbetje industriale të rrezikshme);
- Organizmat e modifikuar gjenetikisht;
- Zhurmat;
- Ndryshimet klimatike;
- Pyjet dhe kullotat;
- Peshkimi;
- Dialogu social.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

- Punësimi;
- Mbrojtja shoqërore;
- Shëndeti dhe siguria në punë;
- Barazia gjinore;
- Politika e migracioni;
- Minoritetet;
- Kimikatet-MPCSSHB (në këtë institucion operon Inspektorati i Punës për Mbrojtjen e Punonjësve në Industri nga Kimikatet).

Ministria e Shëndetësisë

- Shëndeti publik;
- Sëmundjet ngjitëse;
- Mbrojtja nga duhani;
- Mbrojtja nga alkooli;
- Transfuzioni i gjakut;
- Barnat për përdorim njerëzor;
- Pajisjet mjekësore;
- Produktet kozmetike;
- Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet;
- Njohja reciproke e kualifikimeve për profesionet e lira;
- Kimikatet-MSH (është përgjegjëse për kimikatet spitalore dhe barnat).

Ministria e Brendshme

- Administrata publike;
- Reforma e decentralizimit;
- Gjendja civile;
- Menaxhimi i kufijve;
- Azili;
- Krimi i organizuar dhe trafiket e paligjshme;
- Lufta kundër drogës;
- Parandalimi i pastrimit të parave;

- Lufta kundër terrorizmit;
- Policia.

Ministria e Mbrojtjes

- Lufta kundër terrorizmit;
- Çminimi;
- Materialet dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

- Transporti rrugor;
- Transporti hekurudhor;
- Sistemi hekurudhor i shpejtësisë së lartë;
- Mjetet motorike;
- Transporti detar;
- Transporti ajror;
- Infrastrukturë rrugore; Siguria rrugore;
- Materialet e ndërtimit;
- Menaxhimi i ujit të pijshëm;
- Telekomunikacioni;
- Shërbimet postare;
- Kimikatet-MPPTT (është përgjegjëse për kimikatet nga mbetjet urbane).

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

- Arsimi dhe formimi profesional;
- Mosdiskrimini në arsim;
- Arsimi parauniversitar;
- Arsimi i lartë;
- Kërkimi shkencor;
- Njohja e diplomave.

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

- Lëvizja e lirë e mallrave kulturore;
- Kultura dhe turizmi;
- Të drejtat e pronësisë intelektuale.

ANEKSI II

KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E NËPUNËSVE TË NJËSIVE TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Nëpunësi i njësisë së integrimit evropian duhet të për zgjidhet në bazë të kriterëve të përgjithshme të mëposhtme:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë;
- Grada master përbën avantazh;
- Eksperienca në punë të ngjashme përbën avantazh;
- Të ketë aftësi në përgatitje raportesh, analizash, komunikim dhe prezantim;
- Të ketë njohuri shumë të mira në gjuhën angleze;
- Njohja e një gjuhe të dytë të BE-së përbën avantazh;
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter; -
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

VENDIM

Nr. 577, datë 24.6.2015

“PËR NGRITJEN E RRJETIT TË NJËSIVE TË INTEGRIMIT EVROPIAN DHE RRJETIT TË NJËSIVE TË HARTIMIT TË LEGJISLACIONIT NË MINISTRITË E LINJËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 70, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve evropiane të shteteve të tyre anëtare, ratifikuar me Ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e rrjetit të njësive të integrimit evropian, si strukturë e veçantë, dhe rrjetit të njësive të hartimit të legjislacionit, në përbërje të të gjitha ministrive, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së hartimit të legjislacionit dhe përafrimit të tij me acquis të BE-së.
2. Në ato ministri dhe në Departamentin e Administratës Publike (DAP), ku mungojnë sektorët e hartimit të legjislacionit, sek- retarët e përgjithshëm dhe titullari i DAP-it përcaktojnë nëpunës të strukturës, si nëpunës të përfshirë në procesin e hartimit të leg- jislacionit, pjesë të rrjetit të njësive të hartimit të legjislacionit, në përputhje me nevojat e tyre, por, në çdo rast, jo më shumë se 3.
3. Rrjeti i njësive të integrimit evropian dhe rrjeti i njësive të hartimit të legjislacionit bashkërendojnë dhe mbështetin punën e institucioneve respektive për hartimin e një legjislacioni koherent, të qartë dhe transparent, si dhe për transpozimin dhe zbatimin e acquis, sipas kapitujve përkatës, në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.
4. Njësia e integrimit evropian është përgjegjëse, për:
 - a) bashkërendimin e brendshëm institucional, sigurimin e lidhjes së drejtpërdrejtë dhe bashkërendimin e punës me Min- istrinë e Integrimit evropian dhe me ministrinë e tjera të linjës për angazhimet e marra nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të procesit të stabilizim- asociimit;
 - b) bashkërendimin e brendshëm institucional dhe bash- kërendimin e punës me Ministrinë e Integrimit evropian dhe ministrinë e tjera të linjës, për procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me acquis dhe për raportimin e akteve normative, që adaptojnë acquis të BE-së;
 - c) bashkërendimin e brendshëm institucional për përgatitjen e raporteve për procesin e integrimit evropian;
 - ç) monitorimin dhe raportimin brenda ministrisë për çështje të integrimit evropian;
 - d) shpërndarjen e të dhënave për procesin e integrimit evropian ndërmjet ministrisë ku bën pjesë, Ministrisë së Integrimit evropian dhe njësive të integrimit evropian në ministrinë e tjera të linjës;
 - dh) vlerësimin e veprimtarisë së institucionit në raport me ecurinë e procesit të integrimit evropian, propozimin e me- kanizmave funksionalë për lehtësimin e zbatimit të reformave

sektoriale nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përmes procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis* dhe ngritjes së kapaciteteve administrative;

e) bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të programimit e të zbatimit të fondeve të Instrumentit të Paraaderimit IPA II, që i akordohen Shqipërisë në kuadër të integritit evropian;

ë) koordinimin e procesit të evidentimit të nevojave të sektorit përkatës për financim nga BE-ja dhe/apo donatorë të tjerë në përputhje me strategjitë sektoriale;

f) mbështetjen teknike të mbledhjeve të grupeve të përhershme të punës, sipas kapitujve të *acquis*.

5. Njësia e hartimit të legjislacionit është përgjegjëse vetëm, për:

a) hartimin e legjislacionit në përputhje me standardet e teknikës legislative;

b) bashkërendimin me strukturat teknike për përgatitjen e projektakteve;

c) bashkëpunimin me njësinë e integritit evropian dhe Ministrinë e Integritit evropian për garantimin e përputhshmërisë së legjislacionit vendës me *acquis* të BE-së;

ç) çdo detyrë tjetër të lidhur me procesin e hartimit të legjislacionit.

6. Në funksion të përmbushjes dhe realizimit të detyrave të lidhura me hartimin e legjislacionit të rrjetit të njësive të hartimit të legjislacionit, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave krijohet një komision me ekspertë të jashtëm, njohës të mirë të fushave të legjislacionit, sipas rastit, për të mbështetur dhe asistuar këtë rrjet në hartimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe dokumenteve të tjera ligjore.

7. Rregullat më të hollësishme për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të rrjetit, si dhe të komisionit me ekspertë të jashtëm, të përmendur në pikën 6 të këtij vendimi, përcaktohen në rregulloren e veçantë, miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

8. Anëtarët e komisionit me ekspertë të jashtëm përzgjidhen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, duke u bazuar në kritere të tilla, si: përvoja e gjatë në fushën e hartimit të legjislacionit dhe të dokumenteve ligjore, përvoja e gjatë në administratën shtetërore, njohja e legjislacionit ndërkombëtar dhe atij evropian. Anëtarët e komisionit me ekspertë të jashtëm bëjnë deklarinë e gjendjes së konfliktit të interesit, sipas rastit.

9. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës dhe kontrollues të procesit të hartimit të legjislacionit, sa herë e gjykon të nevojshme, thërret mbledhjen e komisionit me ekspertë të jashtëm dhe të nëpunësve të ngarkuar me hartimin e legjislacionit, të këtij rrjeti. Orientimet, udhëzimet dhe detyrat e lëna prej tij në mbledhjet e punës janë të detyrueshme për zbatim.

10. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës dhe kontrollues të procesit të hartimit të legjislacionit, i dërgon vlerësime zyrtarit raportues të nëpunësit civil, të përfshirë në procesin e hartimit të legjislacionit. Ky vlerësim merret në konsideratë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësit civil.

11. Anëtarët e komisionit me ekspertë të jashtëm marrin një shpërblim, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12. Ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit ose të ministrave sigurojnë bashkëpunim institucional, nëpërmjet vënies në dispozicion të të dhënave, informacioneve apo çdo lloj ndihme tjetër, në përputhje me procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga pagesa e anëtarëve të komisionit me ekspertë të jashtëm dhe çdo shpenzim tjetër administrativ, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Kryeministrinë.

14. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi dhe Ministria e Integritimit evropian për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

LIGJ Nr. 15/2015

PËR ROLIN E KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është forcimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 2

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për marrëdhëniet e Kuvendit me Këshillin e Ministrave dhe me institucionet e Bashkimit Evropian, në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 3

Fusha e veprimit të ligjit

Ligji e shtrinë veprimin e tij mbi funksionet e Kuvendit që kanë të bëjnë me:

- a) monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për çështjet e integrimit evropian;
- b) monitorimin e zbatimit të kuadrit normativ që ka të bëjë me integrimin Evropian dhe të fondeve financiare të ofruara nga Bashkimi Evropian;
- c) informimin e publikut për ecurinë e etapave të procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile të përfshirë në këtë proces.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Çështjet Evropiane” janë çështjet që dalin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- b) “Dokumente strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale” janë akte të organit publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ku shprehet vullneti dhe parashikimet për zhvillimin dhe realizimin e një politike të caktuar publike në fushat e ekonomisë, zhvillimit social, drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, dhe marrëdhënieve me jashtë, të cilat mund të përcaktojnë shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore në një periudhë të caktuar kohore, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara në to.
- c) “Fondet e Bashkimit Evropian” janë fondet që akordohen nga Bashkimi Evropian për mbështetjen e vendit tonë në plotësimin e kriterëve dhe kushteve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.
- ç) “Grup interesi” është çdo organizatë jofitimprurëse që ka interesa të përbashkët në fushën e integritit evropian, ose subjekte të tjera të interesuara për çështjet e integritit evropian.
- d) “Institucionet e Bashkimit Evropian” janë institucionet vendimmarrëse të Bashkimit Evropian, si përcaktohen në të drejtën e Bashkimit Evropian.
- dh) “Kudri rregullator i negociatave/bisedimeve për anëtarësim” është kudri që përcakton parimet dhe udhëzimet për negociatat/bisedimet për anëtarësim, i përgatitur nga Komisioni Evropian, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe i miratuar nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.
- e) “Projektakt” është projekti i një ligji, dokumenti strategjik, si dhe projekte të akteve normative, sipas fushës përkatëse të kompetencave, që kanë të bëjnë me çështje të integritit evropian.
- ë) “Legjislacioni i Bashkimit Evropian”, është korpusi ligjor i normave ligjore të detyrueshme dhe të rekomandueshme në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.
- f) “Plani kombëtar për integrimin Evropian, është programi kombëtar i miratuar nga Këshilli i Ministrave, që shërben për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit.
- g) “Ministri përgjegjës” është ministri që përgjigjet për çështjet e integritit evropian.

Neni 5

Parime të përgjithshme

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian bazohet në respektimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të ligjshmërisë, të subsidiaritetit, të proporcionalitetit, të bashkëpunimit reciprok, të transparencës, të gjithëpërfshirjes dhe të ekonomisë së tregut.

KREU II

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Neni 6

Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian

1. Këshilli Kombëtar i Integritit evropian është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian, që ngrihet pranë Kuvendit, i cili nxit dhe garanton bashkëpunimin

gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritimit.

2. Këshilli Kombëtar i Integritimit drejtohet nga Kryetari i Komisionit Parlamentar të Integritimit. Zëvendëskryetar është kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin.

3. Këshilli Kombëtar i Integritimit evropian përbëhet nga:

- a) kryetarët dhe nënkryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare;
- b) përfaqësues të grupeve parlamentare të Kuvendit;
- c) kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin;
- ç) ministri përgjegjës për integrimin;
- d) përfaqësues nga Kabineti i Presidentit;
- dh) përfaqësues nga Kabineti i Kryeministrit;
- e) përfaqësues nga Ministria e Jashtme;
- ë) Prokurori i Përgjithshëm;
- f) Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- g) Avokati i Popullit;
- gj) tre përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, të përfshira në çështje të integritimit evropian.

4. Në takimet e Këshillit Kombëtar të Integritimit evropian marrin pjesë, me statusin e të ftuarit të përhershëm:

- a) titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin;
- b) përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe universiteti publik;
- c) përfaqësues nga media;
- ç) përfaqësues nga organizatat e biznesit, dhomat e tregtisë dhe sindikatat;
- d) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të trupit diplomatik.

5. Këshilli Kombëtar i Integritimit evropian, sipas tematikës së takimit, fton të marrin pjesë edhe ministrat përgjegjës dhe/ose institucionet e varësisë.

6. Këshilli Kombëtar i Integritimit evropian organizon takime periodike.

7. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Byroja e Kuvendit.

Neni 7

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Integritimit

1. Këshilli Kombëtar i Integritimit ka këto përgjegjësi:

- a) nxit bashkëpunimin midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura dhe shoqërisë civile, në procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- b) siguron diskutim të vazhdueshëm për politikën e integritimit evropian, të zbatuara nga institucionet shtetërore, me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar;

- c) monitoron zbatimin e detyrimeve për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian;
- ç) analizon kuadrin ekzistues normativ dhe praktikat, në lidhje me procesin e integritimit
- d) evropian, për çështjet që merr në shqyrtim;
- dh) siguron bashkëpunim të vazhdueshëm për procesin e integritimit me komisionet e përhershme parlamentare dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për integrimin Evropian;
- e) monitoron ecurinë e procesit të negociatave/bisedimeve për anëtarësim;
- ë) këshillon ose jep opinione lidhur me procesin e negociatave;
- f) mban kontakte dhe shkëmben informacion me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian;
- g) zhvillon takime me drejtuesit e grupit negociator dhe drejtuesin e delegacionit shqiptar në negociatat/bisedimet për anëtarësim;
- gj) raporton të paktën një herë në vit në Kuvend mbi punën e Këshillit;

2. Këshilli harton dhe miraton rekomandimin përkatës për çështjet e shqyrtuara.

3. Rekomandimi u përcillet institucioneve që kanë në fus- hën e veprimtarisë së tyre çështjen në fjalë.

4. Gjatë veprimtarisë së tij, Këshilli këshillon për çështje që i vlerëson të rëndësishme për procesin e integritimit evropian.

Neni 8

Sekretariati Teknik

1. Pranë Këshillit Kombëtar të Integritimit evropian funksionon sekretariati teknik, që kryen funksione administrative dhe ndihmëse.

2. Sekretariati teknik përbëhet nga përfaqësues të administratës së Kuvendit, që mbulojnë çështjet legjislative, përafrimin e legjislacionit, monitorimin e institucioneve të pavarura dhe shoqërinë civile, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për integrimin, një përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe ekspertë të pavarur për çështjet e integritimit evropian.

Neni 9

Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociimin

1. Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociimin (Komiteti) është strukturë e përbashkët e Kuvendit dhe Parlamentit Evropian që funksionon sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

2. Komiteti përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Evropian dhe anëtarë të Kuvendit, të cilët propozohen sipas përcaktimeve në Rregulloren e Kuvendit për delegacionet e përhershme pranë organizmave ndërkombëtarë. Për aq sa është e mundur, anëtarët e këtij Komiteti duhet të jenë anëtarë të Komisionit të Integritimit.

3. Komiteti kryesohet me rotacion nga Parlamenti Evropian dhe Kuvendi i Shqipërisë.

4. Komiteti funksionon sipas rregulloreve të brendshme, të miratuar bashkërisht, dhe vendimmarrja realizohet me konsensus.

5. Kuvendi, në seancën më të parë plenare, informohet pas çdo takimi për të gjitha çështjet e diskutuara dhe konkluzionet e takimit.

Neni 10

Komisioni për Integrimin Evropian

Komisioni për Integrimin Evropian është organ i përhershëm i Kuvendit, që ka në fushën e përgjegjësisë së tij çështjet e integritit evropian, përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, monitorimin e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë.

KREU III

KOMPETENCAT DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Neni 11

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit në çështjet Evropiane:

1. Kuvendi, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, në lidhje me çështjet evropiane:

- a) monitoron dhe kontrollon zbatueshmërinë e këtij kuadri ligjor në fushën e integritit evropian dhe të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e tij;
- b) monitoron punën e Këshillit të Ministrave në lidhje me zbatimin e detyrimeve për procesin e integritit në Bashkimit Evropian;
- c) siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- ç) shqyrton raportet/konkluzionet e Bashkimit Evropian dhe qëndrimet e Republikës së Shqipërisë dhe mund të japë rekomandime mbi to;
- d) bashkëpunon me Parlamentin Evropian dhe me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së;
- dh) monitoron punën e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, për çështjet e integritit evropian;
- e) bashkëpunon me shoqërinë civile dhe grupet e interesit.

2. Kuvendi, në lidhje me çështjet Evropiane, angazhohet edhe për:

- a) vendosjen e dialogut të përshtatshëm politik ndërmjet palëve në proces;
- b) monitorimin e zbatimit të kuadrit rregullator për fillimin e negociatave/bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian;
- c) monitorimin e zbatimit të kuadrit rregullator të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit Evropian e shteteve anëtare, nga ana tjetër;
- ç) forcimin e bashkëpunimit rajonal për çështjet e integritit evropian.

Neni 12

Ndërveprimi me institucionet e Bashkimit Evropian

1. Kuvendi merr pjesë në nisma rajonale dhe Evropiane të bash- këpunimit ndërparlamentar, për çështje të integritit evropian.

2. Kuvendi përfaqësohet në këto marrëdhënie nga anëtarë të tij, të cilët propozohen sipas përcaktimit në Rregulloren e Kuvendit për delegacionet e përhershme pranë organizmave ndërkombëtarë.

Neni 13

Detyrimet e Këshillit të Ministrave në marrëdhëniet me Kuvendin Këshilli i Ministrave, me kërkesë të Kuvendit, informon mbi punën e bërë pranë institucioneve të ndryshme të Bashkimit Evropian, veçanërisht për:

- a) projekt marrëveshjet dhe konventat që duhen miratuar me Bashkimin Evropian, në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- b) projektaktet që kanë të bëjnë me angazhimet në traktatet e Bashkimit Evropian, me përjashtim të akteve administrative;
- c) projektaktet e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë dhe që janë të rëndësishme për Republikën e Shqipërisë;
- ç) projektaktet që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve të Bashkimit Evropian.

Neni 14

Përgjegjësitë e Komisionit për Integrimin Evropian Komisioni për Integrimin Evropian, në përmbushje të funksioneve të tij, ushtron edhe këto përgjegjësi:

- a) shqyrton, së bashku me komisionet e tjera parlamentare, projektligjet që kanë lidhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së;
- b) monitoron Këshillin e Ministrave/ministrinë përgjegjëse për çështjet e integritit për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në BE;
- c) nxit ministrinë përgjegjëse për çështjet e integritit evropian, që të hartojë dhe të përditësojë planin kombëtar për integrimin Evropian, si dhe monitoron zbatimin e tij;
- ç) monitoron kuadrin e përgjithshëm të bisedimeve për anëtarësim;
- d) monitoron, së bashku me komisionet e tjera të përhershme, zbatimin e legjislacionit shqiptar të përafruar me legjislacionin e BE-së;
- dh) bashkërendon punën me Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin për të mbajtur marrëdhënie të bashkëpunimit me strukturat e Parlamentit Evropian, si dhe me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së;
- e) bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile për të siguruar informimin dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e integritit evropian;
- ë) harton dhe shqyrton projektrezoluta lidhur me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian;

KREU IV

PJESËMARRJA NË PROCESIN E PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT

Neni 15

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian

1. Këshilli i Ministrave depoziton në Kuvend Planin Kombëtar për Integrimin Evropian.

2. Kuvendi, çdo vit, zhvillon një seancë me debat për detyrat që dalin për Kuvendin, të parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimi Evropian dhe miraton rezolutën përkatëse.

Neni 16

Lista e projektakteve për përafrim legjislacioni

1. Këshilli i Ministrave, brenda muajit janar të çdo viti, i dërgon Kuvendit, listën e përditësuar të projektligjeve, me qëllim programimin e punës së Kuvendit dhe përcaktimin e procedurave të shqyrtimit, sipas rastit.

2. Komisioni për Integrimin Evropian shqyrton listën e projektakteve që synojnë përputhjen e legjislacioni shqiptar me atë të Bashkimit Evropian dhe, në bashkëpunim me komisionet e përhershme të Kuvendit, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, përgatit një raport të posaçëm me rekomandime, të cilat i paraqiten Këshillit të Ministrave.

Projektligjet e përafrimit të legjislacioni

1. Projektligjet që synojnë përputhjen e legjislacioni shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, të paraqitura për miratim në Kuvend, shqyrtohen paraprakisht nga Komisioni për Integrimin Evropian dhe më pas nga komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit, si- pas fushës së përgjegjësisë.

2. Projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit Evropian, në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për instrumentet e përafrimit të legjislacioni vendas me atë të Bashkimit Evropian.

3. Organet e Kuvendit, kur konstatojnë mangësi në këtë dokumentacion, i kthejnë Këshillit të Ministrave projektligjin, i cili brenda 15 ditëve duhet të ridërgohet në Kuvend i plotësuar.

4. Ministria përgjegjëse për integrimin Evropian krijon bazën e të dhënave të tabelave të përputhshmërisë të ligjeve të miratuara, e cila përditësohet nga institucionet që kanë të drejtën e iniciativës legjislative.

5. Institucioni propozues i projektligjit duhet të reflektojë në tabelën e përputhshmërisë të gjitha ndryshimet që ka pësuar projektligji, brenda 15 ditëve nga data e publikimit të ligjit të miratuar.

Neni 18

Raportimi në Kuvend

KREU V

RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA

1. Këshilli i Ministrave, deri më 31 janar të çdo viti, paraqet në Kuvend një raport të detajuar mbi zbatimin e detyrimeve, sipas Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim dhe menaxhimin e fondeve nga Bashkimi Evropian dhe

donatorë të tjerë, për vitin paraardhës. Raporti shqyrtohet në seancë plenare, në përfundim të së cilës Kuvendi miraton rezolutën përkatëse.

2. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se tre javë nga publikimi i Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, raporton në Kuvend për gjetjet, rekomandimet, situatën aktuale të zhvillimeve politike, ekonomike dhe sociale të vendit, si dhe për angazhimet konkrete për përmbushjen e rekomandimeve. Raporti shqyrtohet në seancë plenare, në përfundim të së cilës Kuvendi miraton rezolutën përkatëse.

Raportimi në Komisionin për Integrimin Evropian

1. Ministri përgjegjës për integrimin evropian paraqet në fund të çdo 3-mujori në Komisionin për Integrimin Evropian një raport të hollësishëm mbi:

- a) listën e përditësuar të projektligjeve të lidhura me çështjet e integritit evropian, të cilat do t'i kalojnë për shqyrtim Kuvendit për periudhën vijuese;
- b) ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim;
- c) raportimet e paraqitura pranë strukturave të Komisionit Evropian apo strukturave të përbashkëta, qëndrimet mbi çështjet e diskutuara, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga këto takime.

2. Me kërkesë të Komisionit për Integrimin Evropian ose të 1/3 së anëtarëve të tij, ministri përgjegjës për integrimin Evropian thirret për të informuar mbi çdo çështje që ka të bëjë me koordinimin e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

3. Për zbatimin e planit të veprimeve, të parashikuar në politikat sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuara, si dhe për çështje specifike të fushave të tjera që lidhen me integrimin Evropian, Komisioni thërret edhe ministrat e përkatës.

Neni 20

Raportimi i institucioneve të pavarura

Komisioni për Integrimin Evropian dhe komisionet përgjegjëse, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, mund të thërrasin institucionet kushtetuese të pavarura dhe institucionet e krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, për të raportuar dhe për të dhënë informacione, në çdo kohë, mbi zbatimin e detyrimeve të procesit të integritit evropian dhe zbatimit të kuadrit ligjor përkatës.

Neni 21

Mbikëqyrja e zbatueshmërisë së kuadrit normativ për përafrimin e legjislacionit

1. Komisioni për Integrimin Evropian koordinon me komisionet e përhershme të Kuvendit procesin e mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së kuadrit normativ, që synon përafrimin e legjislacionit, sipas fushave kryesore të integritit evropian.

2. Komisionet e përhershme të Kuvendit, në fund të çdo sesioni parlamentar, u kërkojnë ministrive të linjës të përgatisin një raport lidhur me shkallën e zbatueshmërisë së kuadrit normativ që synon përafrimin e legjislacionit.

3. Raporti, me vlerësimet e komisionit përgjegjës, i dërgohet Komisionit për Integrimin Evropian për të përgatitur analiza vlerësuese.

KREU VI

BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE DHE INFORMIMI I PUBLIKUT

Neni 22

Bashkëpunimi me shoqërinë civile

1. Komisioni për Integrimin Evropian dhe komisionet e përhershme të Kuvendit, sipas fushës së përgjegjësisë, ftojnë grupet e interesit për të marrë pjesë në seanca dëgjimore që lidhen me procesin e integrimit, si dhe në procesin e miratimit të kuadrit ligjor që synon përafrimin e legjislacionit.

2. Komisioni për Integrimin Evropian mund të organizojë takime të hapura me shoqërinë civile për diskutimin e projektit të Planit të Veprimit të Kuvendit, për zbatimin e masave konkrete, lidhur me përparësitë për integrimin në Bashkimin Evropian.

3. Procedurat e detajuara për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Kuvendit.

Neni 23

Transparenca dhe informimi i publikut

1. Kuvendi përcakton rregullat e bashkëpunimit me shoqërinë civile për të garantuar transparencën e veprimtarisë së tij për çështjet e integrimit evropian dhe gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit në këtë proces.

2. Kuvendi, në faqen zyrtare të internetit, krijon një rubrikë të veçantë për informimin e publikut për çështjet e integrimit evropian.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Shfuqizim

Ligji nr. 9252, datë 8.7.2004, “Për punën e Kuvendit në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, shfuqizohet.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

IIIR META

VENDIM I BYROSË SË KUVENDIT

Nr. 67, datë 04.05.2016

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT
EVROPIAN”

Në bazë të nenit 6, pika 7, të Ligjit nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian”, dhe të nenit 8, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, Byroja e Kuvendit.

VENDOSI:

Të miratojë rregulloren e Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ILIR META

RREGULLORJA E KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Neni 1

Objekti

1. Kjo rregullore percakton:

- a) strukturën, rregullat dhe procedurën e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Integrimit evropian (Këshillit);
- b) të drejtat dhe përgjegjësitë e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Këshillit;
- c) transparencën e punës së Këshillit;
- ç) instrumentet ligjorë dhe teknike për zhvillimin e duhur të veprimtarisë administrative dhe teknike të Këshillit

2. Për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, e që kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit të punës së Këshillit, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë dhe Ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

Neni 2

Këshilli Kombëtar i Integrimit evropian

Këshilli Kombëtar i Integrimit evropian është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian që ngrihet pranë Kuvendit, i cili nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integrimit.

Neni 3

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Integrimit

1. Këshilli Kombëtar i Integrimit ka këto përgjegjësi:

- a) nxit bashkëpunimin midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura dhe shoqërisë civile, në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- b) siguron diskutim të vazhdueshëm për politikën e integrimit evropian, të zbatuara nga institucionet shtetërore, me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar;
- c) monitoron zbatimin e detyrimeve për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian;
- ç) analizon kuadrin ekzistues normativ dhe praktikë, në lidhje me procesin e integrimit evropian, për çështjet që merr në shqyrtim;
- d) siguron bashkëpunim të vazhdueshëm për procesin e integrimit me komisionet e përhershme parlamentare dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për integrimin evropian;
- dh) monitoron ecurinë e procesit të negociatave/bisedimeve për anëtarësim;
- e) këshillon ose jep opinione lidhur me procesin e negociatave; mban kontakte dhe shkëmben informacion me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian;
- ë) zhvillon takime me drejtuesit e grupit negociator dhe drejtuesin e delegacionit shqiptar në negociatat/bisedimet për anëtarësim;

f) harton raportin vjetor të veprimtarisë së tij dhe raporton të paktën një herë në vit në Kuvend mbi punën e Këshillit.

2. Këshilli harton dhe miraton rekomandimin përkatës për çështjet e shqyrtuara, i cili u përcillet me shkrim institucioneve që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre çështjen në fjalë.

3. Gjatë veprimtarisë së tij, Këshilli shqyrton dhe këshillon për çdo çështje që e vlerëson të rëndësishme për avancimin e procesit të integritit evropian.

Neni 4

Përbërja e Këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Integritit evropian përbëhet nga:

- a) kryetarët dhe zëvendëskryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare;
- b) kryetarët e grupeve parlamentare të Kuvendit;
- c) kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim- Asociimin;
- ç) ministri përgjegjës për integritin;
- d) përfaqësues nga Kabineti i Presidentit;
- dh) përfaqësues nga Kabineti i Kryeministrit;
- e) përfaqësues nga Ministria e Jashtme;
- ë) Prokurori i Përgjithshëm;
- f) Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- g) Avokati i Popullit;
- gj) tre përfaqësues nga Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC), të përfshira në çështje të integritit evropian.

Të gjithë anëtarët e përhershëm të Këshillit kanë të drejtë vote.

2. Këshilli Kombëtar i Integritit drejtohet nga Kryetari i Komisionit Parlamentar të Integritit. Zëvendëskryetar është kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin.

3. Në takimet e Këshillit Kombëtar të Integritit evropian marrin pjesë me statusin e të ftuarit të përhershëm, pa të drejtë vote:

- a) titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin;
- b) përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti Publik;
- c) përfaqësues nga media;
- ç) përfaqësues nga organizatat e biznesit, dhomat e tregtisë dhe sindikatat;
- d) përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian;
- e) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të trupit diplomatik;

4. Këshilli Kombëtar i Integritit evropian, sipas tematikës së takimit, fton të marrin pjesë ministra të Këshillit të Ministrave, institucionet e varësisë, si dhe ekspertë dhe/ose përfaqësues ndërkombëtar të fushës së integritit.

5. Në mbledhjet e Këshillit ku diskutohet për kapituj të vështirë të acquis, dhe çështje të një interesi të veçantë, mund të marrin pjesë, si të ftuar, edhe organizata të tjera të shoqërisë civile të cilat nuk janë anëtare me të drejtë vote sipas nenit 2, pika 1 gj, me qëllim ofrimin e ekspertizës teknike në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës.

Neni 5

Procedura për zgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të medias në Këshill

1. Këshilli zgjedh tre përfaqësues nga OSHC si anëtar me të drejtë vote, për çdo kapitull të acquis, të cilën ftohen në takimet e Këshillit sipas tematikës së takimit.
2. Subjektet e përcaktuara në shkronjat “gj” të pikës 2, dhe “c”, “ç” të pikës 3, të këtij neni, përzgjidhen nga Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit ndërmjet organizatave që aplikojnë pranë Sekretariatit Teknik për të marrë pjesë në takime.
3. Këshilli Kombëtar shpall thirrjen publike për pjesëmarrje të OSHC në Këshill. Në përzgjedhje përparësi do t’u jepet atyre organizatave që kanë vazhdimësi në veprimtarinë e tyre dhe ofrojnë ekspertizë në lidhje me çështjet e integritetit evropian. Përzgjedhja do të bëhet në bazë të ekspertizës së tyre me legjislacionin dhe politikën e Bashkimit Evropian.
4. Tre përfaqësues nga media përzgjidhen për të marrë pjesë si të ftuar të përhershëm të Këshillit Kombëtar.
5. Përzgjedhja e OSHC-ve dhe e përfaqësuesve të medias do të ripërtërihet çdo 2 vjet.
6. Njoftimi për përfaqësimin e organizatave të shoqërisë civile dhe medias në Këshill, publikohet në faqen e internetit të Këshillit, i shoqëruar me kriteret përzgjedhëse.
7. Pas përzgjedhjes sipas pikës 1 të këtij neni, Sekretariati Teknik harton listën e OSHC-ve të përzgjedhura dhe kapitujve respektiv të acquis në të cilën secila prej tyre kontribuon.
8. Emrat e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile dhe kapitujt e acquis në të cilën ato kontribuojnë, si dhe emrat përfaqësuesve të medias të përzgjedhur, publikohen në faqen e internetit të Këshillit së bashku me emrat e anëtarëve të tjerë të Këshillit.

Neni 6

Përgjegjësitë e Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Këshillit

1. Kryetari i Këshillit thërret takimet e Këshillit, propozon rendin e ditës si dhe drejton takimet e Këshillit. Kryetari i Këshillit së bashku me zëvendëskryetarin nënshkruan të gjitha dokumentet e miratuara nga Këshilli, në veçanti rekomandimet, opinionet dhe deklaratat e Këshillit, dhe ndjek korrespondencën në emër të Këshillit.
2. Kryetari i Këshillit mbikëqyr zbatimin e rekomandimeve dhe të planit vjetor si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara në Rregulloren e Këshillit.
3. Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit, brenda tremujorit të parë të vitit, dorëzojnë në Kuvend dhe paraqesin në seancë plenare raportin vjetor të veprimtarisë së Këshillit.

4. Zëvendëskryetari i Këshillit zëvendëson kryetarin e Këshillit në rast mungese. Në rastin e mungesës së kryetarit, zëvendëskryetari merr përsipër përgjegjësitë e kryetarit, të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë Rregullore. Në rast të mungesës së kryetarit dhe të zëvendëskryetarit njëkohësisht, takimi mund të drejtohet nga një anëtar i Këshillit i autorizuar nga kryetari.

Neni 7

Takimet e Këshillit

1. Këshilli mbledhet të paktën një herë në dy muaj. Takimet e Këshillit thirren nga Kryetari.
2. Këshilli mund të mbledhet edhe kur kjo kërkohet, me shkrim, nga jo më pak se 1/3 e anëtarëve të përhershëm të tij.
3. Takimet e Këshillit zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.
4. Takimet e Këshillit zhvillohen në mjediset e Kuvendit të Shqipërisë dhe janë të hapura, me përjashtim të rasteve kur Këshilli vendos ndryshe.
5. Takimet e Këshillit Kombëtar drejtohen nga Kryetari i Këshillit ose drejtuesi i takimit sipas specifikimeve të Nenit 6 pika 4 të kësaj rregullore;
6. Drejtuesi i takimit sigurohet që t'u jepet fjala të gjithë anëtarëve të Këshillit.
7. Sekretariati Teknik i Këshillit u bën të ditur pjesëmarrësve në takim, jo më vonë se 5 ditë pune përpara, kohën kur do të zhvillohet takimi, rendin e ditës, si dhe u vë në dispozicion materialet e takimit.

Neni 8

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës së takimit përcaktohet nga Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit.
2. Rendi i ditës përmban:
 - a) tematikën që do të trajtohet;
 - b) datën dhe orën e caktuar për mbledhjen e Këshillit;
 - c) listën e çështjeve që do të diskutohen; ç) projekt rekomandimet që do të miratohen.
3. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 3 ditë pune përpara datës së vendosur për mbledhjen.
4. Çështjet e rendit të ditës, të mbetura pa u shqyrtuar në mbledhjen e radhës së Këshillit, kalojnë automatikisht në mbledhjen pasardhëse, me përjashtim të rasteve kur Këshilli vendos ndryshe.

Neni 9

Procesverbalet e takimeve

1. Në takimin e Këshillit mbahet procesverbal i përmbledhur.
2. Sekretariati përgatit procesverbalin e përmbledhur të takimit jo më vonë se 5 ditë pune nga mbajtja e takimit.
3. Për mbajtjen e procesverbalit të përmbledhur zbatohet rregullimi i nenit 39 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Neni 10

Rekomandimet, opinionet dhe deklaratat e Këshillit

1. Në përfundim të çdo takimi, Këshilli harton dhe miraton rekomandimin përkatës për çdo çështje të shqyrtuar.
2. Rekomandimet miratohen, si rregull, me konsensusin e të gjithë anëtarëve, ose të paktën me votat e shumicës së thjeshtë të anëtarëve me të drejtë vote të pranishëm në takim.
3. Rekomandimet, opinionet dhe deklaratat në lidhje me pozitat negociuese të Shqipërisë gjatë procesit të negociatave duhet të miratohen me konsensusin e të gjithë anëtarëve me të drejtë vote.
4. Rekomandimi u përcillet ministrive/institucioneve që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre çështjen në fjalë.
5. Gjatë veprimtarisë së tij, Këshilli mund të nxjerrë opinione dhe deklarata për çështje që i vlerëson të rëndësishme për procesin e integritimit evropian.
6. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, opinioneve dhe deklaratave të Këshillit do të përfshihen në rendin e ditës të seancës së radhës.

Neni 11

Plani vjetor i punës dhe raporti vjetor

1. Këshilli Kombëtar përgatit planin vjetor të aktiviteteve jo më vonë se tre mujori i parë i vitit;
2. Plani vjetor mund të rishikohet e përmirësohet në përputhje me prioritetet kombëtare;
3. Këshilli Kombëtar përgatit raportin vjetor të punës jo më vonë se tremujori i parë i vitit;
4. Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Kombëtar, si përfaqësues të Këshillit prezantojnë raportin vjetor të Këshillit në seancë plenare sikundër është përcaktuar në nenin 6, pika 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Veprimtari të tjera

1. Këshilli mund të organizojë edhe veprimtari të tjera si konferenca, tryeza të hapura, forume debati ose aktivitete informuese në kuadër të ecurisë së procesit të integritimit evropian.

2. Këshilli mund të krijojë grupe pune të posaçme, me ekspertë dhe grupet e interesit, për të diskutuar dhe përgatitur nisma/rekomandime/vlerësime për çështje në sektorë të veçantë/kapituj të veçantë të acquis.

Neni 13

Sekretariati Teknik

1. Sekretariati Teknik funksionon pranë Këshillit Kombëtar të Integritit dhe kryen shërbime teknike, ndihmëse dhe administrative.

2. Sekretariati teknik kryen shërbimet e mëposhtme:

- a) ndihmon dhe mbështet Këshillin në organizimin dhe mbarëvajtjen e takimeve, duke kryer njoftimin e pjesëmarrësve, dërgimin e materialeve, merr masat e duhura për regjistrimin e procesverbalit të mbledhjeve dhe administrimin e tij si dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm;
- b) përgatit të gjitha materialet dhe dokumentacionin e nevojshëm në kuadër të takimeve të radhës së Këshillit;
- c) mbledh dhe përpunon komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e anëtarëve dhe grupeve të interesit për çështje të trajtuara në takimet e Këshillit;
- ç) dërgon në ministritë përkatëse dhe/ose institucione të tjera shtetërore kërkesa për informacion;
- d) përcjell rekomandimet e Këshillit në ministritë përkatëse dhe/ose institucione të tjera shtetërore, për çështje që kanë lidhje me fushën e tyre të përgjegjësisë;
- dh) ndjek zbatimin e rekomandimeve dhe opinioneve të Këshilli, dhe harton informacion të detajuar mbi ecurinë e tyre;
- e) analizon informacionet e dërguara nga institucionet dhe bën sugjerimet përkatëse për përmirësimin e tyre;
- ë) analizon dokumentet strategjike të procesit të integritit dhe informon me shkrim kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Këshillit mbi problematikat e vërejtura si dhe sugjeron përmirësimet teknike të tyre për tu marrë në shqyrtim nga Këshilli;
- f) përgatit raporte dhe studime, me kërkesë të kryetarit dhe/ose zëvendëskryetarit të Këshillit, ose sipas detyrave të caktuara nga mbledhja e Këshillit për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë së Këshillit;
- g) administron dhe përditëson të gjithë informacionin për veprimtarinë e Këshillit, në rubrikën e veçantë për çështjet e integritit evropian, në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit;
- gj) harton planin dhe raportin vjetor të Këshillit Kombëtar;
- h) mban kontakte të rregullta me Komisionin e Integritit evropian dhe komisionet e tjera të Kuvendit;
- i) organizon takimet, tryezat e rrumbullakëta dhe fushatat ndërgjegjësuese për publikun në zbatim të planit vjetor të Këshillit;
- j) mban kontakte të rregullta me Kryeministrinë, ministrinë përgjegjëse për integritit evropian dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme;
- k) mban kontakte të rregullta me organizatat e shoqërisë civile dhe median;

l) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga kryetari dhe/ose zëvendëskryetari i Këshillit.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në konsultim me kryetarin e Këshillit, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, propozon strukturën organizative të sekretariatit teknik, e cila miratohet me vendim të Byrosë së Kuvendit.

4. Sekretariati teknik drejtohet dhe mbikëqyret në punën e tij teknike nga Kryetari i Këshillit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

5. Për mbështetjen e veprimtarisë dhe funksionimit, mund të ftohen ekspertë të jashtëm, sipas fushave dhe nevojave të Këshillit. Kërkesa për ekspertë të jashtëm bëhet nga Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit dhe i përcillet Byrosë së Kuvendit.

Neni 14

Transparenca

1. Sesionet e Këshillit janë të hapura për publikun. Për çështje të veçanta, kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit, propozojnë që takimi të jetë i mbyllur për publikun.

2. Këshilli me shumicën e votave të anëtarëve me të drejtë vote vendos nëse takimi, ose pjesë të tij të jenë të mbyllura për publikun.

3. Në rast të takimit të mbyllur, të gjithë anëtarët dhe të ftuarit e përhershëm janë të detyruar të respektojnë konfidencialitetin e çështjes së diskutuar.

4. Përpara zhvillimit të takimit të mbyllur për publikun, publikohet një njoftim shtypi mbi çështjet që do të diskutohen në takim. Pas përfundimit të këtij takimi, kryetari i Këshillit informon publikun mbi diskutimet në seancën e Këshillit dhe vendimet e marra. 5. Parimi i transparencës do të udhëheqë punën e Këshillit në përgatitjen e njoftimeve të shtypit, konferencave, tryezave të rrumbullakëta dhe seminareve për qëllim të informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut, publikimit të dokumenteve në faqen e internetit, si dhe mënyrave të tjera të shfaqjes publike.

Neni 15

Faqja e internetit

Në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit, në rubrikën e veçantë për çështjet e integritetit evropian, publikohen:

- a) njoftimet zyrtare për zhvillimin e takimeve të Këshillit, rendi i ditës si dhe materialet për çdo çështje që do të diskutohet;
- b) procesverbalet e takimeve të Këshillit;
- c) rekomandimet, opinionet dhe deklaratat e Këshillit për çështje të trajtuara në takimet e tij;
- ç) çdo material tjetër që konsiderohet me interes për t'u publikuar.

Neni 16

Shpenzimet financiare për funksionimin e Këshillit, mbulohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Byrosë, si dhe nga donacione dhe burime të tjera të ligjshme.

Neni 17

Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshimin e Rregullores së Këshillit. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimit me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit, ndryshimet në Rregullore i kalojnë për miratim Byrosë së Ku- vendit.

Neni 18 - Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Byroja e Kuvendit.

VENDIM

Nr. 500, datë 13.9.2017

“PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I: Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Misioni i ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është hartimi dhe zbatimi i politikave të jashtme, drejtimi teknik dhe bashkërendimi i procesit të integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, si dhe bashkërendimi i ndihmave financiare nga Bashkimi Evropian.

III. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar. 2. Realizon shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.
2. Mbështet Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë në përcaktimin e qëndrimeve të rëndësishme lidhur me politikën e jashtme.
3. Mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit, në bashkëpunim të ngushtë me ministrin e Shtetit për Diasporën.
4. Promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare, duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuara në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ekonomike ndërkombëtare, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë.
5. Bashkërendon procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit, hartimit të politikave të integritit, bashkërendimit të ndihmave financiare nga Bashkimi Evropian dhe informimit të publikut për këtë proces.
6. Bashkërendon, programon dhe monitoron ndihmën e Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, sipas përparësive të vendit, në kuadër të procesit të integritit evropian si dhe bashkërendon e ndjek nënshkrimin e marrëveshjeve në lidhje me këto ndihma financiare.

IV. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 941, datë 9.10.2013, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Jashtme”, dhe nr. 946, datë 9.10.2013, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Integritimit Evropian”, shfuqizohen.

V. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

VENDIM

Nr. 749, datë 19.12.2018

“PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SHTETËRORE, PËRGJEGJËSE PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE DHE LIDHJEN E TRAKTATIT TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

2. Struktura e negociatave ka si qëllim arritjen e këtyre objektivave:

- a) realizimin e procesit të shqyrtimit të përafrimit dhe të vlerësimit të legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Evropian (screening);
- b) përcaktimin dhe hartimin e qëndrimeve negociuese të Republikës së Shqipërisë për secilin kapitull të acquis të Bashkimit Evropian;
- c) negocimin dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

II. STRUKTURA E NEGOCIATAVE

1. Struktura përgjegjëse për negociatat përbëhet nga:

- a) Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian;
- b) Delegacioni Shtetëror;
- c) Grupi negociator;
- ç) Misioni i Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- d) Sekretariati i Integritit evropian; dh) Grupet ndërinstitucionale të punës;
- dh) Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian.

2. Organizimi, veprimtaria, funksionimi dhe bashkërendimi i punës së strukturave midis njëra-tjetrës dhe më gjerë kryhen me akt të veçantë.

III. KOMITETI SHTETËROR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian krijohet si organi më i lartë që siguron mbikëqyrjen e strukturës së negociatave dhe bashkërendimin e qëndrimit negociues për secilin kapitull të acquis, përpara miratimit nga Këshilli i Ministrave.

2. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian drejtohet nga Kryeministri dhe në të marrin pjesë:

- a) Kryetari i Delegacionit Shtetëror;
- b) Kryenegociatori;
- c) ministrat përgjegjës për çështjet e brendshme, të ekonomisë, financës dhe drejtësisë;
- ç) Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

3. Në Komitetin Shtetëror për Integrimin Evropian merr pjesë, gjithashtu, ministri që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, si dhe ftohen të marrin pjesë kryetarët e institucioneve të pavarura, sipas tematikës së diskutimit për secilin kapitull të acquis.

4. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian mbështetet nga grupi negociator, siç përcaktohet në kreun V, të këtij vendimi. Procedurat dhe organizmi i punës së Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme.

5. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian vlerëson dhe bashkërendon qëndrimin negociues për secilin kapitull të acquis, të paraqitur nga Kryenegociatori, sipas përcaktimit në pikën 5, të kreut V, të këtij vendimi, me opinionin e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian.

6. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian orienton ministrin që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore për kapitullin përkatës të acquis dhe Kryenegociatorin për propozimin për qëndrimin negociues që do t'i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave.

7. Këshilli i Ministrave miraton qëndrimin negociues për secilin kapitull të acquis, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e përgjegjësisë shtetërore për kapitullin përkatës të acquis, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të kreut VIII, të këtij vendimi.

IV. DELEGACIONI SHTETËROR

1. Delegacioni Shtetëror është organi përgjegjës për zhvillimin e dialogut politik dhe të negociatave me institucionet e Bashkimit Evropian, përfshirë hapjen dhe mbylljen e negociatave për secilin kapitull të acquis të Bashkimit Evropian.

2. Delegacioni shtetëror përbëhet nga:

- a) ministri përgjegjës për punët e jashtme, në funksionin e kryetarit;
- b) Kryenegociatori, në funksionin e zëvendëskryetarit;
- c) kreu i Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian;
- ç) përfaqësues të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, në varësi të fushës së përgjegjësisë shtetërore që është objekt diskutimi me institucionet e Bashkimit Evropian.

3. Delegacioni Shtetëror është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe vepron në përputhje me qëndrimet negociuese të miratuara prej tij, sipas përcaktimit të pikës 6, të kreut III, të këtij vendimi.

4. Delegacioni Shtetëror përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Konferencën Ndërqeveritare Shqipëri - Bashkimi Evropian, në kuadër të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian.

5. Në ushtrimin e funksioneve të tij, delegacioni shtetëror mbështetet nga grupi negociator dhe Sekretariati i Integritimit evropian.

V. GRUPI NEGOCIATOR

1. Grupi negociator krijohet si organi përgjegjës për zhvillimin e procesit teknik të negociatave të aderimit me institucionet e Bashkimit Evropian për çdo kapitull të acquis.

2. Grupi negociator përbëhet nga Kryenegociatori dhe jo më pak se 7 (shtatë) anëtarë. Përbërja e grupit negociator, trajtimi financiar e rregullat e funksionimit të tij dhe detyrat e Kryenegociatorit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

3. Grupi negociator ka përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

- a) diskuton dhe vlerëson projektpropozimet për qëndrimet negociuese të hartuara nga grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të acquis dhe më pas i dërgon ato për shqyrtim në Komitetin Shtetëror për Integritimin Evropian;
- b) zhvillon procesin e diskutimeve e të negociatave për çdo kapitull të acquis, në përputhje me qëndrimet negociuese të miratuara nga Këshilli i Ministrave;
- c) monitoron dhe bashkërendon zbatimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të dokumenteve strategjike për procesin e Integritimit evropian;
- ç) ndjek zbatimin e kërkesave dhe të udhëzimeve të Komitetit Shtetëror për Integritimin Evropian;
- d) raporton në Komitetin Shtetëror për Integritimin Evropian për veprimtaritë në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian;
- dh) drejton procesin e përditësimit të planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- e) vlerëson dhe finalizon dokumentet dhe raportet e përgatitura në kuadër të takimeve të Komitetit dhe nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit;
- ë) vlerëson ndikimin në financat publike të buxhetit të shtetit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- f) vlerëson ndikimin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me acquis;
- g) vlerëson përparësitë e programit të Bashkimit Evropian të Asistencës (IPA), ecurinë e projekteve të financuara nga programet e Asistencës së Bashkimit Evropian apo nga donatorë të tjerë në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- gj) çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me akt të veçantë.

4. Kryenegociatori i paraqet për opinion Këshillit Kombëtar për Integritimin Evropian qëndrimin negociues për secilin kapitull të acquis, të përgatitur nga grupi ndërinstitucional i punës përkatës.

5. Kryenegociatori i paraqet për shqyrtim Komitetit Shtetëror për Integritimin Evropian qëndrimin negociues për secilin kapitull të acquis, të përgatitur nga grupi ndërinstitucional i punës përkatës, së bashku me opinionin e Këshillit Kombëtar për Integritimin Evropian.

6. Anëtarët e grupit negociator bashkëkryesojnë nënkomitetet e Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE.

7. Grupi negociator mbështetet në funksionet e tij nga Sekretariati i Integritit evropian, siç përcaktohet në kreun VII, të këtij vendimi.

VI. MISIONI I SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian është përgjegjës për:

- a) mbështetjen e komunikimit diplomatik dhe teknik me institucionet e Bashkimit Evropian dhe me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian;
- b) organizimin e agjendës së takimeve dhe të shkëmbimit të qëndrimeve përkatëse të palëve për çështjet e diskutuara në kuadër të negociatave për çdo kapitull të acquis të Bashkimit Evropian.

VII. SEKRETARIATI I INTEGRIMIT EVROPIAN

1. Sekretariati i Integritit evropian (Sekretariati) përbëhet nga nëpunës diplomatë dhe civilë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për Europën dhe Punët e Jashtme.

2. Sekretariati është përgjegjës për koordinimin e politikave kombëtare me ato të Bashkimit Evropian dhe ofron asistencë teknike e administrative për Komitetin Shtetëror për Integritin Evropian, Delegacionin Shtetëror, grupin negociator dhe grupet ndërinstitucionale të punës në përgatitjen e negociatave për secilin kapitull të acquis.

3. Sekretariati i Integritit evropian, përveç detyrave funksionale në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, ushtron edhe këto funksione:

- a) bashkërendon dhe mbështet aktivitetin e grupeve ndërinstitucionale të punës si në kuadër të detyrimeve të procesit të Stabilizim-Asociimit, ashtu edhe në kuadër të procesit të negociatave për çdo kapitull të acquis të Bashkimit Evropian;
- b) bashkërendon dhe mbështet hartimin e raportit analitik përfundimtar të harmonizimit të legjislacionit vendas me acquis të Bashkimit Evropian (screening) nga secili grup ndërinstitucional pune, siç përcaktohet në kreun VIII, të këtij vendimi;
- c) mbledh dhe përpunon projektpropozimet për qëndrimet negociuese për çdo kapitull të acquis të Bashkimit Evropian, sipas projektpropozimeve dhe qëndrimeve negociuese hartuara nga secili grup ndërinstitucional pune, siç përcaktohet në kreun VIII, të këtij vendimi;
- ç) koordinon ndërveprimin dhe shkëmbimin e qëndrimeve negociuese e të dokumentacionit përkatës ndërmjet Komitetit Shtetëror për Integritin Evropian, Delegacionit Shtetëror, Grupit Negociator dhe Kryenegociatorit me Grupet Ndërinstitucionale të Punës;
- d) administron bazën e të dhënave elektronike për monitorimin e procesit të negociatave dhe të detyrimeve që rrjedhin prej tij;
- e) kryen funksione të tjera teknike dhe administrative, që përcaktohen nga kryetari i Delegacionit Shtetëror dhe Kryenegociatori, në kuadër të procesit të negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4. Sekretariati i kryen funksionet e tij nën udhëzimet e Kryenegociatorit.

5. Rregullat e funksionimit të Sekretariatit të Integrimit evropian miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e Integrimit evropian dhe Punët e Jashtme.

VIII. GRUPET NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Për secilin kapitull të acquis të Bashkimit Evropian krijohet një grup ndërinstitucional pune.

2. Grupet ndërinstitucionale të punës janë përgjegjëse për:

- a) analizën e politikave, të legjislacionit, financimit, investimeve, procedurave administrative, ndërveprimit social e të sipërmarrjes private dhe të zbatimit gjyqësor për fushën përkatëse, të mbuluar nga kapitulli përkatës i acquis;
- b) përgatitjen e vlerësimit analitik të harmonizimit të legjislacionit vendas me acquis të Bashkimit Evropian;
- c) përgatitjen e propozimeve për qëndrimet negociuese për çdo kapitull të acquis të Bashkimit Evropian dhe përcjelljen e tyre te grupi negociator;
- ç) përgatitjen e dokumentacionit dhe të raporteve vlerësuese për piketat paraprake (opening benchmarks) dhe piketat përfundimtare (closing benchmarks) për kapitullin përkatës, duke përfshirë edhe diskutimet apo qëndrimet e dala në negociatat për atë kapitull;
- d) analizimin në mënyrë periodike të kapaciteteve administrative dhe rekomandimin për forcimin e tyre, kur është e nevojshme;
- e) përcaktimin, në konsultim me anëtarin e grupit negociator përgjegjës për kapitullin përkatës, të prioriteteve të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit
- ë) Evropian dhe përditësimin periodik të këtij përafrimi;
- f) çdo detyrë tjetër, në kuadër të përgatitjes dhe zhvillimit të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian, sipas kërkesës së Kryenegociatorit apo të kryetarit të Delegacionit Shtetëror.

3. Përgjegjësitë e ministrive të linjës apo të institucionit të pavarur në secilin grup ndërinstitucional pune dhe struktura e tyre caktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

4. Strukturat e integrimit evropian në ministritë, institucionet e pavarura dhe institucionet në varësi të Kryeministrit/ministrave, mbështesin funksionimin e secilit grup ndërinstitucional pune, në cilësinë e sekretariatit teknik të tij, sipas fushës së kompetencës, nëpërmjet koordinimit të strukturave të institucionit ku ato bëjnë pjesë, sa herë i kërkohet nga kryetari i grupit ndërinstitucional të punës përkatës.

5. Grupi ndërinstitucional i punës kryesohet nga një zëvendësministër ose sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse, në varësi të fushës së kompetencës dhe lidhjes së saj me kapitullin përkatës të acquis të Bashkimit Evropian apo përfaqësuesi i institucionit të pavarur, kur fusha e kompetencës për kapitullin e caktuar të acquis i takon një institucioni të pavarur.

6. Kryetari i secilit grup ndërinstitucional të punës administron grupin e punës në përputhje me kërkesat e anëtarit të grupit negociator përgjegjës për negociatat për kapitullin në fjalë. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës është përgjegjës për veprimtarinë e tij tek anëtari përkatës i grupit negociator përgjegjës për koordinimin e një kapitulli negociues të veçantë.

7. Kryetari dhe anëtarët e secilit prej grupeve ndërinstitucionale të punës emërohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrave apo drejtuesve të institucioneve të pavarura përgjegjëse. Në përbërjen e grupeve ndërinstitucionale të punës, përveç përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse për secilin kapitull, mund të bëjnë pjesë dhe ekspertë, sipas fushës së tyre të kompetencës.

8. Kryetarët e grupeve ndërinstitucionale të punës organizojnë Komitetin Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës. Rregullat e funksionimit të Komitetit miratohen me urdhër të Kryeministrit.

9. Në funksion të procesit të Stabilizim-Asociimit, grupet ndërinstitucionale të punës janë përgjegjëse për dorëzimin pranë ministritë përgjegjëse për Evropën të kontributit:

- a) në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian;
- b) për raportin vjetor të Komisionit Evropian;
- për të gjitha raportet periodike në lidhje me procesin e stabilizimasociimit;
- ç) për 7 nënkomitetet e Stabilizim-Asociimit;
- d) për takimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit;
- dh) për takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit.

IX. PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Informimi, konsultimi, komunikimi dhe përfshirja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, sindikatave, botës akademike dhe organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian si dhe në procesin e Stabilizim-Asociimit realizohen nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian.

2. Pjesëmarrja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, biznesit, sindikatave, botës akademike dhe organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian për monitorimin e politikave publike gjatë procesit të negocimit nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian, si dhe dhënia e ekspertizës në fusha të ndryshme të acquis të Bashkimit Evropian është e hapur për to, sipas fushës përkatëse të kompetencës.

3. Format e pjesëmarrjes, funksionimi dhe struktura institucionale e Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian miratohen me urdhër të Kryeministrit.

X. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Çdo efekt financiar, që mund të lindë nga zbatimi i këtij vendimi, përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për ministritë dhe institucionet zbatuese.

2. Ngarkohen ministritë, institucionet e pavarura dhe institucionet në varësi të Kryeministrit/ ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

SENIDA MESI

URDHËR KRYEMINISTRI

Nr. 93, datë 20/05/2019

“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TEKNIK TË GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS”

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 8, të kreut VIII, të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”,

URDHËR O J:

1. Komiteti Teknik i Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (në vijim “Komiteti Teknik/KTGNP”) ka si qëllim të drejtojë, vlerësojë, monitorojë dhe koordinojë realizimin e angazhimeve të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (në vijim “GNPIE”), për çështje teknike specifike, që lindin në kuadër të:

- a) negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian;
- b) zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;
- c) harmonizimit të së drejtës së Bashkimit Evropian në kuadrin e të drejtës vendase;
- ç) asistencës teknike të ndihmës së Bashkimit Evropian apo donatorëve të tjerë për Shqipërinë, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

2. Komiteti Teknik të kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për Integrimin Evropian në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në funksionin e Kryetarit dhe në përbërje të ketë kryetarët e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës, në funksionin e anëtarëve.

3. Në mbledhjen e Komitetit Teknik marrin pjesë, sipas rastit, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit Negociator.

4. Komiteti Teknik mbledhet, si rregull, të paktën dy herë në muaj, me njoftim të kryetarit dhe/ose me kërkesë të anëtarëve. Kryenegociatori mund të kërkojë mbledhjen e KTGNP sa herë e gjykon të nevojshme.

5. Thirrja e mbledhjes (njoftimi), së bashku me rendin e ditës (agjendën) të propozuar të mbledhjes dhe dokumentet për diskutim, i njoftohet secilit anëtar të Komitetit Teknik të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar për mbajtjen e mbledhjes, në mënyrë elektronike. Thirrja përfshin informacionin mbi vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes.

6. Përgjashtimisht dhe në raste urgjente, Kryetari i Komitetit Teknik, mund të thërrasë një mbledhje, pa njoftuar paraprakisht rendin e ditës dhe materialin për diskutim, jo më vonë se 1 (një) ditë përpara ditës së përcaktuar për mbajtjen e mbledhjes. Në këtë rast rendi i ditës i propozuar dhe materiali për diskutim vihen në dispozicion anëtarëve në fillim të mbledhjes.

7. Rendi i ditës i propozuar nga kryetari, sipas pikës 5 dhe 6, miratohet në fillim të mbledhjes me votat e shumicës së anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Çdo kërkesë për diskutimin e çështjeve të caktuara mund të miratohet të bëhet pjesë e rendit të ditës, në të kundërt çështja diskutohet nën rubrikën “çështje të ndryshme” përpara përfundimit të mbledhjes.

8. Mbledhja e Komitetit Teknik drejtohet nga Kryetari dhe në rast se kryetari mungon apo është në pamundësi për të ushtruar funksionin e tij, ai cakton një zëvendëskryetar, jo më vonë se 2 (dy) ditë përpara datës së mbledhjes.

9. Kryetari zgjedh si zëvendëskryetar dhe i delegon detyrën e tij, njërit prej kryetarëve të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës, sipas tematikës së diskutimit në rendin e ditës.

10. Sekretariati për Integrimin Evropian (në vijim “Sekretariati”), i siguron mbështetje teknike dhe administrative Komitetit Teknik, për zhvillimin e veprimtarisë së tij.

11. Konkluzionet për çështjet në rendin e ditës, votohen me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.

12. Votimi në mbledhjen e Komitetit Teknik është i hapur dhe çdo anëtar mund të shpjegojë votën e tij. Arsyetimi përfshihet në procesverbalin e mbledhjes.

13. Procesverbali miratohet në fillim të mbledhjes së ardhshme/ radhës të Komitetit Teknik.

14. Komiteti Teknik ushtron këto funksione:

- a) Monitoron dhe koordinon angazhimet e GNPIE-ve, për procesin e integritit evropian;
- b) Zbaton kërkesat dhe udhëzimet e Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian;
- c) Raporton në Komitetin Shtetëror për Integrimin, sipas nevojës, për veprimtaritë e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës, në kuadër të procesit të integritit në Bashkimit Evropian;
- ç) Drejton dhe zgjidh problematikat që pengojnë kryetarët e GNP-ve të marrin informacionin e nevojshëm nga institucionet përgjegjëse për realizimin e funksioneve të tyre.
- d) Adreson mosmarrëveshjet e mundshme ndërmjet institucioneve duke përcaktuar përgjegjësinë për harmonizimin dhe zbatimin e “acquis” të BE-së për kapitullin përkatës tek institucionet përgjegjëse.

15. Urdhri nr. 46, datë 01.04.2009, i Kryeministrit, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e strukturave të bashkërendimit ndërministror, për realizimin e angazhimeve, të ndërmarra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, shfuqizohet.

16. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

URDHËR KRYEMINISTRI

Nr. 94, datë 20/5/2019

“PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN”

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të Ligjit Nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të Vendimit Nr. 500, datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjëseve shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, dhe të pikës 3 dhe 7, të kreut VIII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”

U R D H Ë R O J:

I. GRUPET NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Krijimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (në vijim “GNPIE”) për secilin kapitull të acquis të Bashkimit Evropian, duke përfshirë Kapitullin e Kriterit Politik dhe Kapitullin e Kriterit Ekonomik, si më poshtë vijon:

- a) GNPIE Kapitulli “Kriteri Politik”
- b) GNPIE Kapitulli “Kriteri Ekonomik”
- c) GNPIE Kapitulli 1 “Lëvizja e Lirë e Mallrave”
- ç) GNPIE Kapitulli 2 “Lëvizja e Lirë e Punëtorëve”
- d) GNPIE Kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”
- dh) GNPIE Kapitulli 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”
- e) GNPIE Kapitulli 5 “Prokurimi Publik”
- ë) GNPIE Kapitulli 6 “Legjislacioni për shoqëritë tregtare”
- f) GNPIE Kapitulli 7 “E drejta e Pronësisë Intelektuale”
- g) GNPIE Kapitulli 8 “Politika e Konkurrencës”
- gj) GNPIE Kapitulli 9 “Shërbimet Financiare”
- h) GNPIE Kapitulli 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”
- i) GNPIE Kapitulli 11 “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”
- j) GNPIE Kapitulli 12 “Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”
- k) GNPIE Kapitulli 13 “Peshkimi”
- l) GNPIE Kapitulli 14 “Politika e Transportit” ll) GNPIE Kapitulli 15 “Energjia”
- m) GNPIE Kapitulli 16 “Tatimet”
- n) GNPIE Kapitulli 17 “Politikat Ekonomike dhe Monetare”
- nj) GNPIE Kapitulli 18 “Statistikat”
- o) GNPIE Kapitulli 19 “Politikat Sociale dhe të Punësimit”
- p) GNPIE Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”
- q) GNPIE Kapitulli 21 “Rrjetet transevropiane”

- r) GNPIE Kapitulli 22 “Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore”
- rr) GNPIE Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”
- s) GNPIE Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”
- sh) GNPIE Kapitulli 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”
- t) GNPIE Kapitulli 26 “Arsimi dhe kultura”
- th) GNPIE Kapitulli 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”
- u) GNPIE Kapitulli 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik”
- v) GNPIE Kapitulli 29 “Bashkimi Doganor”
- x) GNPIE Kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë”
- xh) GNPIE Kapitulli 31 “Politika e jashtme e sigurisë dhe e mbrojtjes”
- y) GNPIE Kapitulli 32 “Kontrolli financiar”
- z) GNPIE Kapitulli 33 “Dispozitat Financiare dhe Buxhetore”.

II. FUSHA E VEPRIMIT DHE DETYRAT E GNPIE-ve

1. Fusha e veprimit të çdo GNPIE-je përcaktohet nga përmbajtja tematike e kapitullit të acquis përfshirë kapitujt “Kriteri Politik” dhe “Kriteri Ekonomik”

2. Për realizimin e përgjegjësisë të përcaktuara në Vendimin Nr. 749, datë 19.12.2018 të Këshillit të Ministrave, secila GNPIE të kryejë këto detyra kryesore, në fushën e përgjegjësisë së saj.:

- a) Të përcaktojë përgjegjësinë për harmonizimin dhe zbatimin e acquis për kapitullin përkatës të institucionet përgjegjëse dhe të adresojë mosmarrëveshjet e mundshme ndërmjet tyre;
- b) Të bashkërendojë përgatitjen dhe përditësimin e analizës së mangësive ligjore për çdo pjesë të acquis, bazuar në kontributin e institucioneve/drejtorive përgjegjëse;
- c) Të identifikojë aktorët e interesuar për pjesë të caktuara të procesit të negociatave;
- ç) Të bashkërendojë përgatitjen e prezantimit të situatës aktuale të kapitullit përkatës të acquis në kuadër të procesit “screening” dypalësh;
- d) Të bashkërendojë përgatitjen e informacionit mbi projekt raportin “screening” për kapitullin përkatës të acquis, në procesin e negociatave, të përgatitur nga Komisioni Evropian, si dhe çdo raport tjetër shpjegues që nevojitet për të komentuar ose për të mbështetur deklaratat në këtë informacion bazuar në kontributin e institucioneve/drejtorive përgjegjëse për çdo pjesë të “acquis”
- dh) Të bashkërendojë përgatitjen e qëndrimit negociues për kapitullin përkatës të acquis, bazuar në kontributin e institucioneve/drejtorive përgjegjëse për çdo pjesë të acquis;
- e) Të bashkërendojë përgatitjen e projekt planit të veprimit për realizimin e detyrave në mbështetje të procesit të hapjes të negociatave për kapitullin përkatës të acquis, në përgjigje të kërkesës të Komisionit Evropian;
- ë) Të monitorojë dhe raportojë përmbushjen e planit të veprimit për realizimin e detyrave në mbështetje të kapitullit negociues përkatës, sipas nevojës;
- f) Të bashkërendojë përgatitjen e informacionit ndaj projektqëndrimit të përbashkët në lidhje me kapitullin negociues, si dhe çdo dokument tjetër mbështetës që kërkohet;
- g) Të administrojë dhe shpërndajë informacionin lidhur me fazën përgatitore dhe procesin e negociatave;

- gj) Të bashkërendojë përgatitjen e raporteve informative ose tematike për kapitullin përkatës të *acquis*, sipas kërkesës;
- h) Të bashkërendojë procesin e identifikimit të nevojave për asistencë teknike në kuadër të negociatave për anëtarësimin;
- i) Të kryejë vlerësimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të saj dhe të dërgojë këtë vlerësim pranë Shkollës Shqiptare e Administratës Publike dhe Sekretariatit për Integrimin Evropian, për planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të nevojshme;
- j) të bashkërendojë informacionin për planifikimin dhe nevojën për përkthimin e *acquis* përkatës për kapitullin negociues;
- k) Të bashkërendojë procesin e hartimit dhe të përditësimit çdo vit për kapitullin përkatës të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (në vijim “PKIE”), si dhe çdo dokumentacion apo informacion tjetër për këtë qëllim dhe merr pjesë në çdo aktivitet të strukturave përkatëse, në kuadër të Procesit të Stabilizim Associmit, nën koordinimin e Sekretariatit të Integritimit Evropian;
- l) Të bashkërendojë procesin lidhur me sigurimin e përputhjes së PKIE –s me politikat e tjera dhe dokumentet strategjike në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Mosmarrëveshjet ndërmjet GNPIE-ve lidhur me fushën e veprimtarisë dhe *acquis* përkatës zgjidhen me dakordësinë e kryetarëve të GNPIE-ve. Në rast të mos arritjes të një dakordësie, mosmarrëveshja zgjidhet me vendim të Komitetit Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (në vijim “KTGNP”).

III. PËRBËRJA E GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Çdo GNPIE përbëhet nga:

- a) kryetari;
- b) zëvendëskryetari;
- c) sekretari i përhershëm;
- ç) anëtarët përfaqësues nga secili institucion kontribuues për atë kapitull;
- d) anëtari përfaqësues i Sekretariatit të Integritimit Evropian (në vijim “koordinatori”);
- dh) anëtari përfaqësues nga ministria përgjegjëse për fushën e financave;
- e) anëtari përfaqësues nga Instituti i Statistikave (INSTAT), dhe
- ë) anëtarët përfaqësues të institucionit përgjegjës për kryesimin e kapitullit.

2. Institucioni përgjegjës për kryesimin e secilit kapitull të *acquis* dhe institucionet kontribuuese për atë kapitull përcaktohen në shtojcën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kryetari dhe zëvendëskryetari i GNPIE-së propozohen nga institucioni përgjegjës për kryesimin e kapitullit. Kryetari i GNPIE-së mund të jetë një zëvendës ministër ose sekretari i përgjithshëm i ministrisë, drejtuesi apo sekretari i përgjithshëm i institucionit të pavarur apo përkatësisht drejtuesi i institucionit të vartësisë, përgjegjës për kryesimin e kapitullit. Zëvendëskryetari i GNPIE-së është nëpunës i nivelit drejtues të institucionit përgjegjës për kryesimin e kapitullit

4. Anëtarët që propozohen nga institucioni përgjegjës për kryesimin e kapitullit apo institucioni kontribues janë nëpunës të vetë institucionit, si rregull, të strukturave përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe strukturave rregullatore apo mund të jenë edhe persona me ekspertizën përkatëse jashtë institucionit.

5. Çdo institucion përgjegjës për kryesimin e kapitullit apo institucion kontribues, propozon numrin e nevojshëm të anëtarëve për të mbuluar çdo pjesë të acquis për të cilin është përgjegjës por jo me pak se 2 (dy) anëtar për çdo nën-kapitull të acquis për të cilin institucioni kontribuon.

6. Anëtari përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat propozohet nga ministri përkatës, ndërsa anëtari përfaqësues nga Instituti i Statistikave (INSTAT) propozohet nga titullari i INSTAT.

7. Sekretari i Përhershëm i GNPIE-së është një nga nëpunësit e strukturës së integritit evropian, të institucionit përgjegjës për kryesimin e kapitullit, propozuar nga ky institucion.

8. Për çdo anëtar, përfshirë sekretarin e përhershëm, institucioni propozon, gjithashtu, një anëtar zëvendësues që zëvendëson anëtarin kryesor në rast pamundësie të përkohshme të këtij të fundit.

9. Përbërja nominale e anëtarëve të GNPIE-së, përfshirë emrat e anëtarëve “zëvendësues” miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit ose titullarit të institucionit përgjegjës për drejtimin e GNPIE-së. Urdhri përditësohet sipas nevojës, por jo më pak se një herë në vit.

IV. RREGULLAT E PUNËS TË GNPIE-ve

1. GNPIE funksionon në mënyrë të përhershme dhe kryen detyrat e përcaktuara në këtë urdhër me kontributin e secilit anëtar të tij, sipas pjesës përkatëse të përgjegjësisë për acquis. Çdo anëtar i GNPIE-së drejton dhe kordinon punën e strukturave të institucionit që përfaqëson, për realizimin e detyrave të GNPIE-së, për pjesën përkatëse të acquis, që është ngarkuar të mbulojë.

2. Organizimi dhe koordinimi i punës të GNPIE realizohet nga Kryetari të GNPIE-së, në konsultim me anëtarin e grupit negociator, përgjegjës për kapitullin përkatës (në vijim, negociatori).

3. Në kryerjen e detyrave të tij, kryetari mbështetet nga nënkryetari. Nënkryetari zëvendëson kryetarin në rast të pamundësie të përkohshme apo kryen detyra specifike të caktuara nga kryetari.

4. Për organizimin e punës, ndarjen e detyrave, diskutimin dhe dakordësimin e qëndrimeve për çështje të caktuara, GNPIE-ja zhvillon mbledhje të përgjithshme apo mbledhje tematike. Mbledhjet tematike mund të mbahen edhe për nënkapituj të acquis apo çështje të caktuara.

5. Mbledhjet e përgjithshme zhvillohen të paktën 1 (një) herë në 2 (dy) muaj. Mbledhjet tematike mbahen sipas nevojës ose në përputhje me dinamikën e caktuar nga GNPIE.

6. Dakordësimi i qëndrimeve të anëtarëve të GNPIE-së për çështje të caktuara, bëhet në një mbledhje të përgjithshme apo tematike të GNPIE-së, me konsensus të anëtarëve. Në rast të mos arritjes së një dakordësie, mosmarrëveshja zgjidhet me vendim të KTGNP.

7. Mbledhja e GNPIE-së thirret nga dhe sipas rendit të ditës të përcaktuar nga kryetari i GNPIE-së, me iniciativë të vetën; me kërkesë të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme; të kryenegociatorit; të anëtarit të grupit negociator përgjegjës për kapitullin përkatës; apo me kërkesën e të paktën 5 (pesë) anëtarëve të GNPIE-së.
8. Në mbledhjen e GNPIE-së kanë të drejtë të marrin pjesë, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, kryenegociatori, anëtarët e grupit negociator, përfaqësues të Kuvendit dhe përfaqësues të strukturës përkatëse për kodifikimin në Ministrinë e Drejtësisë.
9. Në mbledhjet e GNPIE, sipas nevojës, ftohen të marrin pjesë, përfaqësues nga akademia, biznesi, shoqëria civile, si dhe përfaqësues të tjerë nga grupet e interesit, sipas vlerësimit të kryetarit të GNPIE-së.
10. GNPIE mund të krijojë nëngrupe pune për nënkapituj të kapitullit përkatës të *acquis* apo çështje specifike në fushëveprimin e tij. Nëngrupet e punës krijohen me vendim të kryetarit të GNPIE-së.
11. Nëngrupi i punës ngarkohet, të përgatisë materiale ndihmëse për çështjet specifike dhe ti paraqesë ato në GNPIE, si dhe i raporton rregullisht mbi veprimtarinë e tij kryetarit GNPIE- së përkatëse.
12. Vendimi për ngritjen e nëngrupit të punës, përcakton çështjet, detyrat, afatet, anëtarësia dhe anëtari i ngarkuar për drejtimin dhe koordinimin e nëngrupit të punës.
13. Anëtarët e GNPIE-së janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e GNPIE-së kanë të drejtë të diskutojnë e të marrin pjesë në dakordësimin e qëndrimeve.
14. Anëtarët e GNPIE-së apo të nëngrupeve kanë të drejtën e qasjes në informacion e dokumente që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave në GNPIE-së.
15. Anëtarët e GNPIE-së apo të nëngrupeve detyrohen të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme.
16. Përjashtimisht, në rast pamundësie për të marrë pjesë në një mbledhje, anëtari i GNPIE-së njofton paraprakisht, nëpërmjet sekretarit të përhershëm, kryetarin e GNPIE-së. Edhe në këtë rast anëtari ka mundësi të paraqesë, me shkrim, përfshirë në mënyrë elektronike, mendimin e tij për çështjet në rendin e ditës.
17. Në rast se një anëtar i GNPIE-së mungon në mënyrë të përsëritur në mbledhjet e GNPIE-së dhe nuk kryen detyrat ose shkel rregullat e punës sipas këtij urdhri, kryetari i GNPIE-së ka të drejtë të propozojë zëvendësimin e tij.
18. Kryetari i GNPIE- ja harton çdo 2 (muaj) një raport periodik për veprimtarinë e GNPIE-së, sipas formatit të përcaktuar nga ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme. Raporti i paraqitet ministrit për Evropën dhe Punët e jashtme, titullarit të institucionit përgjegjës për kryesimin e kapitullit, kryenegociatorit, dhe anëtarit të grupit negociator përgjegjës për kapitullin përkatës.
19. GNPIE- ja harton dhe miraton çdo 6 (gjashtë) muaj një raport mbi progresin për kapitullin përkatës. Formatit i raportit përcaktohet nga ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme. Raporti publikohet në faqen on-line të institucionet përgjegjës për kapitullin.

20. Publiku, mund të informohet për punimet e GNPIE-së nëpërmjet ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, kryenegociatorit, një anëtar të grupit negociator, kryetarit të GNPIE-së apo një anëtar të GNPIE-së i autorizuar shprehimisht nga kryetari.

V. MBËSHTETJA E PUNËS TË GRUPEVE NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Struktura përgjegjëse për integrimin evropian në institucionin përgjegjës për kryesimin e kapitullit të GNPIE-së, vepron si sekretariat i GNPIE-së duke i siguruar mbështetje teknike dhe administrative dhe koordinimin e strukturave të institucionit përgjegjës dhe institucioneve të varësisë.

2. Institucioni përgjegjës për kryesimin e kapitullit vë në dispozicion ambientet dhe infrastrukturën tjetër të nevojshme për zhvillimin e punimeve të GNPIE-së.

3. Sekretariati i Integritit, nëpërmjet Koordinatorit përkatës, është përgjegjës për mbështetjen teknike dhe shqyrtimin e dokumenteve të përgatitura nga GNPIE-të sipas detyrave të referuara në pikën 2, të kreut II të këtij Urdhri, si dhe koordinimin e ndërveprimit mes GNPIE dhe grupit negociator.

VI. DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave për zbatimin e këtij Urdhri.

2. Ministritë dhe institucionet qendror në varësi të Kryeministrit/ministrave të përcaktuara si institucione përgjegjës për kryesimin e çdo kapitulli, koordinojnë punën për mbledhjen e propozimeve për anëtarët e GNPIE-ve nga institucionet kontribuuese dhe propozojnë anëtarët për secilën GNPIE- brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

3. Ministria dhe institucioni qendror në varësi të Kryeministrit/ministrave që ka rolin më të rëndësishëm, për kapitullin përkatës, në rastin kur institucioni përgjegjës për kryesimin e kapitullit është një institucioni i pavarur, koordinon punën për mbledhjen e propozimeve për anëtarët e GNPIE-ve nga institucioni kryesues dhe institucionet e tjera kontribuuese dhe përgatit listën përfundimtare të anëtarëve për secilën GNPIE brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

4. Ftohen institucionet e pavarura, të përcaktuara si institucione përgjegjës për kryesimin e çdo kapitulli apo si institucion kontribuues, të propozojnë anëtarët e tyre për secilën GNPIE brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

5. Urdhri Nr. 107, date 28.02.2014, i Kryeministrit, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstytucionale të punës për integrimin evropian”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



SHTOJCA NR. 1: INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE KRYESUESE DHE KONTRIBUUESE PËR SECILIN KAPITULL

Kapitulli	Nën-kapitulli	Institucioni Kryesues	Institucionet Kontribuese
Kapitulli “Kriteri Politik”	<p>1.Funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma në administratën publike demokracia; reforma në administratën publike</p> <p>2. Shteti i së drejtës</p> <p>3. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve</p> <p>4. Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare</p>	Ministria e Drejtësisë	<p>Kuvendi; Prokuroria e Përgjithshme (PP); Avokati i Popullit;</p> <p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ); Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDHP); Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD); Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm; Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Inspektoriat i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Këshilli i Lartë i Gjqësorit (KLGJ); Kryeministria (KM);</p> <p>Departamenti i Administratës Publike (DAP); Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC); Ministria e Brendshme (MB); Drejtoria e Përgjithshme e Policia e Shtetit; Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Agjencia Kombëtare e Kadastrës</p>

			<p>Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin Ministria e Kulturës Komiteti Shtetëror i Minoriteteve Shkolla e Magjistraturës Komisioni i Pavarur i Kualifikimit Kolegji i Posaçëm i Apelimit Komisionerët Publikë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit Këshilli i Lartë i Prokurorisë Inspektori i Lartë i Drejtësisë</p>
Kapitulli “Kriteri Ekonomik”	<p>1. Egzistenca e një ekonomie tregu funksionale 2. Aftësia për tu përballur me presionin konkurrues dhe forcate tregut brenda BE-së.</p>	Ministria e Finanave dhe Ekonomisë	<p>Ministria e Drejtësisë Banka e Shqipërisë (BSH); Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiar (AMF); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Drejtësisë (MD); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Zyra e Kryeministrit</p>
Kapitulli 1. “Lëvizja e Lirëe Mallrave”	<p>1. Parimet e përgjithshme; 2. Çështjet horizontale; standardisation; vlerësimi i konformitetit; akreditimi; metrologjia; mbikëqyrja e tregut. 3. Direktivat e përqasjes së vjetër 4. Direktivat e përqasjes së re dhe globale; 5. Masat procedurale procedurat e</p>	Ministria e Finanave dhe Ekonomisë	<p>Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Ministria e Kulturës (MK); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Ministria e Mbrojtjes (MMb); Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE); Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);</p>

	njoftimit; kontrollet në kufijtë e jashtëm të Bashkimit; armët e zjarrit; objektet e trashëgimisë kulturore.		Instituti i Statistikave (INSTAT); Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Ministria e Brendshme (MB); Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS); Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM); Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) Ministria e Drejtësisë; Policia e Shtetit;
Kapitulli 2. “Lëvizja e Lirë e Punëtorëve”	1. Aksesi në tregun e punës; 2. EURES 3. Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore 4. Karta Evropiane e Sigurimit Shëndetësor	Ministria e Finanave dhe Ekonomisë	Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP); Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH); Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH); Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Ministria e Brendshme (MB) Instituti i Statistikave (INSTAT); Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve shoqërore (ISHPSHSH) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc);
Kapitulli 3 “E drejta e Vendosijes dhe liria për të ofruar shërbime”	1. E drejta e themelimit 2. Liria për të ofruar shërbime ndërkufitare; 3. Shërbimi postar; 4. Njohja reciproke ekualifikimeve profesionale	Ministria e Finanave dhe Ekonomisë	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP); Ministria e Drejtësisë (MD); Ministria e Kulturës (MK); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);

			<p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Brendshme (MB); Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK) Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA); Instituti i Statistikave (INSTAT). Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK); Agjencia e Inovacionit dhe Kërkimit Shkencor (AKSHI) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) Autoriteti Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) Qendra e Edukimit Shkencor (CES) Agjencia Kombëtare e Formimit Profesional (AKFP) Banka e Shqipërisë</p>
Kapitulli 4 “Lëvizja e lirë e Kapitalit”	<p>1.Regjimi i lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave aktuale; 2. Sistemi i pagesave; 3. Parandalimi i pastrimit të parave</p>	Banka e Shqipërisë	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP); Ministria e Drejtësisë (MD); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF); Instituti i Statistikave (INSTAT). Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p>
Kapitulli 5 “Prokurimi Publik”	<p>1.Parimet e përgjithshme 2. Dhënia e kontratave publike</p>	Agjencia e Prokurimit Publik	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Brendshme (MB);</p>

	3. Mjetet ligjore		Komisioni i Prokurimit Publik (KPP); Ministria e Mbrojtjes (MMb); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve (ATK) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (DPP) Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (DSIK) Instituti i Statistikave (INSTAT).
Kapitulli 6 “Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare”	1. Legjislacioni tregtar; 2. Kontabiliteti dhe auditimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB); Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK); Bordi i Mbikqyrjes Publike (BMP); Banka e Shqipërisë (BSH); Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF); Instituti Shqiptar i Auditimit të Brendshëm (AIIA); Instituti i Statistikave (INSTAT). Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMSip);
Kapitulli 7 “ Edrejta e Pronësisë Intelektuale”	1. E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të 2. Të drejtat e pronësisë industriale Zbatimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPI);	Ministria e Kulturës (MK); Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Inspektoriati i Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Prokuroria e Përgjithshme (PP); Shkolla e Magjistraturës; Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Ministria e Drejtësisë (MD);

			Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT); Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI); Instituti i Statistikave (INSTAT)
Kapitulli 7 “ Edrejta e Pronësisë Intelektuale”	1.E drejta e autorit dhetë drejtat e lidhura me të 2. Të drejtat e pronësisëindustriale Zbatimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPI);	Ministria e Kulturës (MK); Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Inspektoriati i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Prokuroria e Përgjithshme (PP); Shkolla e Magjistraturës; Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Ministria e Drejtësisë (MD); Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT); Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI); Instituti i Statistikave (INSTAT)
Kapitulli 9 “Shërbimet Financiare”	1.Bankat dhe konglomeratët financiarë 2. Siguracionet dhe pensionet; 3. Infrastruktura e tregut financiar 4. Bursa dhe shërbimete investimeve	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Banka e Shqipërisë (BSH); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Instituti i Statistikave (INSTAT). Agjencia e Sigurimit te Depozitave
Kapitulli 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”	1.Strategjia e tregut unik digjital 2. Komunikimet elektronike dhe teknologjia e komunikimit dhe e informacionit (TKI);	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP); Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Ministria e Brendshme (MB); Policia e Shtetit

	3. Shoqëria e informacionit; 4. Politika audiovizive		Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI); Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK); Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Kuvendi i Shqipërisë; Radio Televizioni Shqiptar (RTSH); Instituti i Statistikave (INSTAT).
Kapitulli 11 “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”	1.Çështjet horizontale <i>mbështetja e drejtpërdrejtë;financimi i Politikës të Përbashkët Bujqësore – CAP (Fondi Evropian i Garancisë Bujqësore –EAGF, Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural- EAFRD; Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit- IACS; agjencia e pagesave; mekanizmat e tregtisë;letrat me vlerë; Rrjeti i të Dhënave të kontabilitetit Bujqësor (FADN); ndihmat shtetërore; jo të aneksit I; të ndryshme.</i> 2.Organizimi i Tregut të Përbashkët; <i>bimët e arave, fibra, drithëra, ushqim i thatë, fara vajore, kultura proteine, niseshte patateje oriz,</i>	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Ministria e Drejtësisë (MD)/ Agjencia Kombëtare e Kadastrës (AK) Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)

	<p><i>liri dhe kërpi, pambuku, krimbat e mëndafshit, sheqeri</i></p> <p>3. Prodhimi shtazor; <i>qumështi dhe produkte me bazë qumështi; mishi i viçit; mish i deleve dhe dhenve mishi i derrit vezët, mish i pulës mjalti</i></p> <p>4. Bimët/kulturat e specializuara; <i>vera dhe alkooli; frutat dhe perimet; bananet; florikultura; vaji i ullirit; duhani; farat; hopsi.</i></p> <p>5. Zhvillimi Rural;</p> <p>6. Politika e cilësisë;</p> <p>7. Produktet organike;</p>		
<p>Kapitulli 12 “Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve”</p>	<p>1. Çështje të përgjithshme <i>Ligji për Ushqimin dhe Ushqyesit (Rreg. 178/2002) Komitetet Autoriteti Europian për Sigurinë Ushqimore Trajnimi Aktet e Aderimit</i></p> <p>2. Politika veterinare; <i>sistemi i kontrollit në tregun e brendshëm; sistemi i kontrollit për importet identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe regjistrimi i lëvizjeve të tyre; masat e kontrollit për sëmundjet e kafshëve; tregtia brenda BE-së në</i></p>	<p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV) Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve (ARSHVMB)</p>

farë, vezë dhe embrione të kafshëve të gjalla; lëvizja jo për arsye tregtare e kafshëve shtëpiake; ndalimi i substancave dhe kontrolli i mbetjeve; kriteret e importit për kafshët e gjalla dhe nënproduktet e tyre; marrëveshjet ndërkombëtare të BE- së; mirëqenia e kafshëve; zooteknika; shpenzimet veterinare.

3.Vendosja në treg e ushqimit, ushqyesëve dhe produkteve shtazore; *rregullat e higjenës; rregulla të posaçme për produktet shtazore; rregullat e kontrollit; rregullat e posaçme të kontrollit për produktet shtazore; rregullat për nënproduktet shtazore; financimi i kontrolleve; rregullat e posaçme për higjenën e ushqyesëve.*

4. Rregullat e sigurisë ushqimore

5.Rregullat specifike për ushqyesit vendosja në treg dhe përdorimi i ushqyesëve; *aditivët e ushqyesëve; substancat e padëshirueshme; ushqyesit mjekësor; marrëveshjet ndërkombëtare komunitare*

	<p>6.Politika fitosanitare; <i>shëndeti i bimëve (organizmat e dëmshëm, produktet për mbrojtjen e bimëve); cilësia e farave dhe materiale promociionale; të drejtat e varieteteve bimore; marrëveshjet ndërkombëtare të BE- se</i></p> <p>7.Organizmate modifikuar gjenetikiisht përhapja në mjedis e ushqimit dhe ushqyesëve të modifikuar gjenetikiisht</p>		
<p>Kapitulli 13 “Peshkimi”</p>	<p>1.Menaxhimi i burimeve dhe i flotës së peshkimit</p> <p>2.Inspektimi dhe kontrolli</p> <p>3.Veprimtaria strukturore</p> <p>4.Politika e tregut</p> <p>5.Ndihma shtetërore</p> <p>6.Marrëveshjet ndërkombëtare</p>	<p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</p>	<p>Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)</p>
<p>Kapitulli 14 “Politika e Transportit”</p>	<p>1.Transporti rrugor</p> <p>2.Transporti hekurudhor</p> <p>3.Transporti i brendshëm ujor;</p> <p>4.Transporti i kombinuar</p> <p>5.Transporti ajror</p> <p>6.Transporti detar</p>	<p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</p>	<p>Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH); Drejtorja e Përgjithshme e Hekurudhave; Drejtorja e Përgjithshme e Transportit Detar; Autoriteti Kombëtar i Aviacionit Civil; Instituti i Statistikave (INSTAT).</p>

Kapitulli 15 “Energjia”	1.Siguria e furnizimit; 2.Tregu i brendshëm i energjisë; 3.Energjia e rinovueshme 4.Efiçenca e energjisë 5.Investimet në infrastrukturë 6. Energjia bërthamore 7. Siguria nga energjia bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Enti Rregullator i Energjisë (ERE); Agjencia Kombëtare Bërthamore; Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet; Instituti i Statistikave (INSTAT).
Kapitulli 16 “Tatimet”	1.Tatimi indirekt TVSH akciza 2. Tatimi direkt; 3. Bashkëpunimi administrativ dhe ndihma e ndërsjellë 4. Kapaciteti operacional dhe kompjuterizimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Instituti i Statistikave (INSTAT). Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);
Kapitulli 17 “Politikat Ekonomike dhe Monetare”	1.Politika monetare; 2. Politika ekonomike	Banka e Shqipërisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Instituti i Statistikave (INSTAT); Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF); Instituti i Statistikave (INSTAT).
Kapitulli 18 “Statistikat”	1.Statistikat Demografike dhe sociale 2. Klasifikimet dhe regjistrat 3. Statistikat ekonomike 4. Statistikat sektoriale 5. Statistikat e mjedisit dhe multidomain	INSTAT	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Ministria e Drejtësisë Ministria e Mbrojtjes Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Banka e Shqipërisë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

			Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve shoqërore (ISHPSHSH)
Kapitulli 19 “Politikat Sociale dhe të Punësimit”	1. Legjislacioni i punës; 2. Siguria dhe shëndetinë punë; 3. Dialogu social; 4. Politika e punësimit 5. Fondi Social Evropian; Përfshirja sociale (social inclusion) 7. Mbrojta sociale 8. Anti diskriminimi 9. Shanset e barabarta	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH); Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD); Avokati i Popullit; Ministria e Brendshme (MB); Policia e Shtetit Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve; Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH); Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH); Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; Instituti i Statistikave (INSTAT). Inspektorati Shtetëror I Punës dhe Shërbimeve shoqërore (ISHPSHSH)
Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”	1. Parimet e politikës së sipërmarrjes dhe asaj industriale 2. Instrumentet e politikës së sipërmarrjes dhe asaj industriale 3. Politikat sektoriale 4. Inovacioni	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM); Ministria e Kulturës (MK); Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB); Autoriteti i Konkurrencës (AK); Banka e Shqipërisë (BSH); Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT);

			<p>Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH); Ministria e Drejtësisë (MD); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) Ministria e Mbrojtjes Ministria e Kulturës Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) Agjencia e Prokurimit Publik Fondi i Zhvillimit Shqiptar (ADF) Bashkimi i Dhomave të Tregtisë së Shqipërisë (UCCIAL) Këshilli i Investimeve Agjencia e Inovacionit dhe Kërkimit Shkencor (AKSHI) Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Këshilli i Ministrave (Departamenti i Koordinimit të Politikave)</p>
Kapitulli 21 “Rrjetet Trans-Evropiane”	<p>1. Rrjetet Evropiane të Transportit; 2. Rrjetet Evropiane të Energjisë; 3. Rrjetet Evropiane të Telekomunikacionit</p>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	<p>Autoriteti Rrugor Shqiptar; Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave; Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Detar; Enti Rregullator i Energjisë; Instituti i Statistikave (INSTAT).</p>
Kapitulli 22 “Politikat Rajonale dhe Koordinimi i	<p>1. Kuadri ligjor 2. Kuadri institucional 3. Kapacitetet administrative</p>	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Instituti i Statistikave (INSTAT); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);</p>

Instrumenteve Strukturore	4. Programimi Monitorimi dhe vlerësimi 5. Menaxhimi dhe kontrolli financiar		Autoriteti i Auditit të Fondeve të Bashkimit Evropian Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Zyra e Kryeministrit Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Kapitulli 23 “Gjyqëtori dhe të Drejtat Themelore”	1. Sistemi gjyqësor; 2. Politikat kundër korrupsionit; 3. Të drejtat e njeriut	Ministria e Drejtësisë	Kuvendi; Inspektoriati i Lartë Kontrollit të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Prokuroria e Përgjithshme (PP); Këshilli i Lartë i Gjyqësorit (KLGJ); Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Brendshme (MB); Ministria e Mbrojtjes (MMb); Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDHP); Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD); Agjencia e Trajtimit të Pronës (ATP); Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP); Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit (DPP); Shërbimi i Provës (SHP); Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB); Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH); Ministria e Kultures (MK); Gjykata e Lartë; Shkolla e Magjistraturës; Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Gjykata Kushtetuese;

			<p>Departamenti i Administratës Publike (DAP); Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ); Ministria e Financave dhe Ekonomise (MFE); Avokati i Popullit; Avokatura e Shtetit; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Instituti i Statistikave (INSTAT). Këshilli i Lartë i Prokurorisë Inspektori i Lartë i Drejtësisë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit Kolegji i Posaçëm i Apelit Komisionerët Publikë DAP Shkolla e Administratës Publike Shqiptare (ASPA) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare Agjencia Kombëtare e Kadastrës Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</p>
<p>Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria Siguria”</p>	<p>1. Lufta kundër krimittë organizuar 2. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës; 3. Lufta kundër terrorizmit; 4. Migracioni (i rregullt dhe jo); 5. Azili; 6. Politika e vizave; 7. Shengen dhe kufijtë e jashtëm; 8. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale 9. Sistemi doganor (referuar në kapitullin 29); 10. Mbrojta e EURO-s nga falsifikimi</p>	<p>Ministria e Brendshme</p>	<p>Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP); Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK); Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Ministria e Drejtësisë (MD);</p>

	(aspektet kriminale)		<p>Prokuroria e Përgjithshme (PP); Ministria e Mbrojtjes (MMb); Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm; Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH); Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Banka e Shqipërisë; Instituti i Statistikave (INSTAT). Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)</p>
Kapitulli 25“Shkenca dhe Kërkimi Shkencor”	<p>1.Politikat e kërkimit shkencor dhe inovacionit 2. Programet kuadër 3. Inovacioni dhe Hapësira e Kërkimit Evropian 4. Kërkimi shkencor nëfusha specifike</p>	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	<p>Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI); Instituti i Statistikave (INSTAT).</p>
Kapitulli 26 “Arsimi dhe Kultura”	<p>1.Arsimi dhe formimi profesional; 2. Kultura</p>	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Ministria e Kulturës (MK); Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA); Qendra e Zhvillimeve Arsimore (QSHA); Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL); Instituti i Statistikave (INSTAT) Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK);</p>

<p>Kapitulli 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimaterike”</p>	<p>1.Mjedisi, <i>Legjislacioni horizontal; cilësia e ajrit; menaxhimi i mbetjeve; cilësia e ujit; mbrojtja e natyrës; ndotja industriale, menaxhimi i risqeve; kimikatet; mbrojtja nga zhurmat; mbrojtja e popullisë.</i> 2.Ndryshimet klimaterike</p>	<p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</p>	<p>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise (MIE); Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Ministria e Mbrojtjes (MMb); Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve; Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujrave; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Agjencia Kombëtare e Turizmit; Agjencia Kombëtare e Bregdetit; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN); Instituti i Shëndetit Publik (ISHP); Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU); Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor; Instituti i Statistikave (INSTAT).</p>
<p>Kapitulli 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik”</p>	<p>1.Mbrojtja e konsumatorit <i>aspekte horizontale; çështje të lidhura mesigurinë e produkteve; çështje jo të lidhurame sigurinë;</i> 2.Shëndeti publik <i>aspekte horizontale; kontrolli i duhanit; sëmundjet e transmetueshme; gjaku, indet, qelizat dhe organet; të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor</i></p>	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p>	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc); Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve; Banka e Shqipërisë (BSH); Instituti i Shëndetit Publik (ISHP); Inspektorati Shëndetësor Shtetëror; Spitalet Universitare; Qendra Kombëtare e Kontrollit të Gjakut; Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave; Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);</p>

	<p><i>ndërkufitar; shëndeti mendor;</i> 3. përcaktimet social- ekonomike të kujdesit shëndetësor, <i>pabarazia në kujdesin shëndetësor; alkooli, kanceri, shëndeti dhe mjedisi</i></p>		<p>Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH); Instituti i Statistikave (INSTAT). Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), Ministria e Turizmit dhe e Mbrojtjes së Mjedisit (MTM) Inspektorati i Turizmit (IT) Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Enti Rregullator i Energjisë (ERE); Enti Rregullator i Ujit (ERU); Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF); Ministria e Drejtësisë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP)_ Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Rinisë Inspektoriati Shtetëror i Punës (ISHP) Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Agjencia Kombëtare për Mjekësinë dhe Pajisjet Medicinale</p>
<p>Kapitulli 29 “Doganat”</p>	<p>1.Legjisllacioni doganor 2. Kapacitetet administrative dhe operacionale</p>	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Ministria e Kulturës (MK); Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK); Instituti Statistikave (INSTAT);</p>

Kapitulli 30 “Marrëdhëniet me Jashtë”	1. Politika e përbashkëttregtare; <i>OBT dhe çështje të tjera horizontale; kreditimi i eksporteve; përdorimi i dyfishtë imallrave.</i> 2. Marrëveshjet dypalëshe me vendet e treta; 3. Bashkëpunimi për zhvillim 4. Ndihmahumanitare	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ); Ministria e Mbrojtjes (MMb); Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR); Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE); Emergjencat Civile; Instituti Statistikave (INSTAT);
Kapitulli 31 “Politika e Jashtme e Sigurisë dhe e Mbrojtjes”	1. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë - dialogu politik; 2. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë dhe Mbrojtjes – strategjia politike; <i>sanksionet dhe masat kufizuese; parandalimi i konflikteve; bashkëpunimi i me organizatat ndërkombëtare masat e sigurisë (informacioni i klasifikuar)</i> 3. Kapacitetet kontribuuese në Politika e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes; <i>menaxhimi i krizave civile; menaxhimi i krizave ushtarake</i>	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Ministria e Mbrojtjes (MMb). MB/Policia e Shtetit
Kapitulli 32 “Kontrolli Financiar”	1. Auditimi i jashtëm (shtetëror); 2. Auditimi i brendshëm; 3. Kontrolli i brendshëm financiar	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH); Banka e Shqipërisë (BSH); Instituti i Statistikave (INSTAT). Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);

	<p>publik (KBFP);</p> <p>4. Inspektimi financiar publik;</p> <p>Mbrojtja e EURO-s nga falsifikimi</p>		<p>Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit)</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMSoc);</p> <p>KM (Agjencia e Auditimit e Fondeve te BE)</p> <p>Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural</p>
<p>Kapitulli 33</p> <p>“Dispozitat</p> <p>Financiare dhe</p> <p>Buxhetore”</p>	<p>1. Detyrimet doganore</p> <p>2. Burimi me bazë TVSH</p> <p>3. Burimi me bazë PBB</p> <p>4. Infrastruktura administrative</p>	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT);</p> <p>Instituti Statistikave (INSTAT).</p>

URDHËR KRYEMINISTRI

Nr.113, datë 30/08/2019

“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PLATFORMËS SË PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN”

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të kreut IX, të vendimit nr.749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”,

URDHËR O J:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian e cila ka si qëllim:

- a) të rrisë ndërgjegjësimin publik procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- b) të shpjegojë ndikimin e procesit të anëtarësimit për vendin dhe shoqërinë;
- c) të informojë mbi procesin e negociatave dhe progresin e bërë për çdo fazë, duke krijuar mundësi për përthithjen e ekspertizës vendase në fushat përkatëse;
- ç) të mbështesë një përfaqësim gjithëpërfshirës të të gjithë partnerëve publikë dhe privatë në procesin e stabilizim-asociimit dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- d) të mundësojë aksesin e shoqërisë civile, pushtetit vendor, komunitetit të biznesit, shoqatave të punëmarrësve, botës akademike dhe grupeve të interesit, për këshillim e monitorim në fazat e programimit e zbatimit të asistencës së Bashkimit Evropian për procesin e integritit evropian.

2. Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian mbështetet dhe funksionon në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për të drejtën e informimit, si dhe njoftimit e konsultimit publik.

3. Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian zhvillon procesin e informimit dhe këshillimit në lidhje me:

- a) Projektqëndrimin negociues të Republikës së Shqipërisë për kapitullin përkatës të *acquis*;
- b) programimin e monitorimit e ndihmës së Bashkimit Evropian;
- c) hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian ose planeve të tjera në kuadër të procesit të integritit evropian;
- ç) çështje të tjera të cilat duhet të këshillohen me strukturat joshtetërore të përfaqësimit publik në kuadër të procesit të integritit.

II. FORMAT E PJESËMARRJES

1. Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian organizohet me dy nivele përfaqësimi:

- a). Bordi Drejtues, i cili drejton Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian.

Bordi Drejtues të kryesohet nga Kryeministri dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ketë në përbërje të tij 15 anëtarë, si më poshtë vijon:

- i. Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- ii. Kryenegociatori;
- iii. Drejtuesit e Sekretariatit të Integritimit Evropian;
- iv. Drejtorin përgjegjës për bashkëpunimin territorial për zbatimin e projekteve IPA;
- v. Drejtorin përgjegjës për koordinimin e programeve kombëtare dhe rajonale të IPA-s;
- vi. dy përfaqësues të shoqatave të organeve të pushtetit vendor;
- vii. dy përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile;
- viii. dy përfaqësues të komunitetit të biznesit;
- ix. dy përfaqësues të shoqatave të punëmarrësve;
- x. dy përfaqësues të botës akademike.

b). 33 Tryeza të Diskutimit dhe Këshillimit, të cilat krijohen në mënyrë analoge me kapitujt e “acquis” të Bashkimit Evropian.

III. FUNKSIONIMI

III.1 Funksionimi i Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues është struktura më e lartë e Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian, që garanton bashkëpunimin institucional me grupet e interesit dhe marrjen në konsideratë apo vlerësimin e opinioneve, qëndrimeve dhe ekspertizës së tyre për procesin e integritimit evropian.
2. Kryetari i Bordit Drejtues përveç funksioneve të tjera, drejton mbledhjet, propozon rendin e ditës, drejton diskutimet në lidhje me qëndrimet gjithëpërfshirëse për procesin e integritimit evropian.
3. Bordi Drejtues, pasi mbledh sugjerimet nga Tryezat, miraton me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje, rregulloren e brendshme, ku përcaktohen procedurat e detajuara të funksionimit të Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian.
4. Anëtarët e Bordit Drejtues të përmendur në nënndarjet vi, vii, viii, ix dhe x, të shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, zgjidhen nga anëtarët e të gjithë Tryezave. Mandati i tyre është 3-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.
5. Bordi Drejtues mbledhet të paktën çdo tre muaj, megjithatë kryetari mund të kërkojë mbledhjen e Bordit Drejtues në çdo rast sipas nevojave të procesit.
6. Bordi Drejtues mbështetet nga Sekretariati i Integritimit Evropian.
7. Bordi drejtues miraton raportin vjetor mbi funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian.

III.2. STRUKTURA INSTITUCIONALE

1. Qëllimi kryesor i secilës tryezë është të diskutojë, të shqyrtojë dhe të ndërmarrë qëndrime dhe rekomandime drejtuar institucioneve, Sekretariatit të Integritimit Evropian e strukturave të tjera përgjegjëse në procesin e integritimit evropian, për çështjet e fushat specifike që trajtojnë.

Tryezat gjithashtu këshillohen në lidhje me programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e asistencës së Bashkimit Evropian për Shqipërinë.

2. Tryezat kryesohen nga drejtuesit e grupeve ndërinstitucionale të punës e koordinohen nga ministrinë dhe institucionet kryesuese të kapitujve, sipas fushës së kompetencës së tyre. Secila nga Tryezat e diskutimit dhe këshillimit ka në përbërje të saj përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, shoqatave të punëmarrësve, botës akademike, medias dhe të grupeve të interesit.

3. Në takimet e Tryezave të diskutimit dhe këshillimit, në varësi të tematikës së mbledhjes, ftohen të marrin pjesë edhe negociatorët sipas kapitujve negociues dhe koordinatorët e Sekretariatit të Integrimit Evropian.

4. Për të qenë anëtar në secilën prej Tryezave, ftohen të marrin pjesë lirisht përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, botës akademike, medias dhe të grupeve të interesit.

5. Aplikimi për tu bërë pjesë e Tryezave kryhet nëpërmjet dorëzimit të një Letër Interesi si dhe CV-je të personit apo të grupimit që përfaqëson, ku tregohet se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në Tryezën/at specifike.

6. Për ngritjen e Tryezave, pranimi apo refuzimi i aplikimeve bëhet nga grupet ndërinstitucionale të punës. Në rastin e anëtarëve të rinj, pranimi ose refuzimi i aplikimit bëhet nga grupet ndërinstitucionale të punës. Refuzimi i aplikimit duhet të jetë gjithmonë i arsyetuar.

7. Përfaqësimi i Tryezave në Bordin Drejtues bëhet përmes zgjedhjes nga të gjithë anëtarët e Tryezave të ngritura, të dy përfaqësuesve për secilën prej kategorive të përcaktuara në gërmat vi, vii, viii, ix, dhe x të shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, të këtij Urdhri. Dy kandidatët e secilës kategori më shumë të votuar nga anëtarët e Tryezave të pranishëm në votim, për zgjidhen në Bordin Drejtues. Një pjesëtar i Tryezave voton vetëm njëherë, pavarësisht nëse është anëtar në më shumë se një tryezë. Kandidatët për t’u zgjedhur në Bordin Drejtues mund të propozohen nga një anëtar i Tryezave ose të vetëpropozohen.

8. Tryezat mbledhen sipas nevojës nga drejtuesit e grupeve ndërinstitucionale të punës, duke caktuar periodicitet nëse shihet e arsyeshme, por jo më pak se një herë në muaj, ose mbledhen me kërkesë nga të paktën një e treta e anëtarëve

VI. DISPOZITA E FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të gjitha institucionet kryesuese të grupeve ndërinstitucionale të punës për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

REZOLUTË E KUVENDIT

Datë 03.10.2019

“PËR MBËSHTETJEN E PROCESIT TË FILLIMIT TË BISEDIMEVE PËR ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN.”

Në zbatim të nenit 6 dhe nenit 75 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”, nenit 14, pika (ë) e ligjit nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, nenit 106 dhe nenit 107 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe duke marrë në konsideratë rolin e Kuvendit, si organi më i lartë ligjberës dhe kontrollues;

- Duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme të Bashkimit Evropian për ngritjen dhe forcimin e institucioneve demokratike të Republikës së Shqipërisë;

- Duke ritheksuar se objektivi kryesor strategjik i Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, me mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave për procesin e integritit evropian;

- Duke konfirmuar vullnetin e palëkundur për të respektuar vlerat e sanksionuara në traktatet e Bashkimit Evropian dhe vendosmërinë për zhvillimin e një shoqërie demokratike, bazuar në sundimin e ligjit, respektin për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve, si dhe në parimet e ekonomisë së tregut;

- Duke marrë në konsideratë rekomandimin e qartë të Komisionit Evropian të datës 17.04.2018, rikonfirmuar në datën 29.05.2019, për fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian si dhe përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian, të mbështetura nga Këshilli Evropian, të qershorit 2018, i cili përcakton fundin e vitit 2019 si periudhën e zyrtarizimit të këtyre bisedimeve;

- Duke vlerësuar punën përgatitore të nisur nga Komisioni Evropian me institucionet shqiptare në lidhje me analizën e legjislacionit shqiptar kundrejt acquis të Bashkimit Evropian të njohur si procesi “screening”;

- Duke rikonfirmuar angazhimet që burojnë nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë nr. 1621 datë 24.05.2018, “Për rekomandimin e Komisionit Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimit midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë”;

- Duke marrë në konsideratë faktin se dialogu politik konstruktiv, gjithëpërfshirja dhe transparenca, të mbështetura në parimet demokratike dhe institucionet kushtetuese janë thelbësore për progresin e qëndrueshëm të institucioneve të Shqipërisë në procesin e integritit evropian;

- Duke shprehur angazhimin tonë për të vijuar reformat e ndërmarra në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe duke patur parasysh përparimin e bërë nga Shqipëria në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit Evropian, zbatimin e qëndrueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, dhe në veçanti përparësitë e vendosura nga Komisioni Evropian si kusht paraprak për çeljen e negociatave;
- Duke marrë në konsideratë raportin e fundit të OSBE/ODIHR dhe duke konsideruar themelore zbatimin e rekomandimeve të raportit të mësipërm për reformën zgjedhore sipas parimeve demokratike dhe brenda kuadrit kushtetues dhe institucional;
- Duke theksuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të përfshirjes dhe rolit të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit, në procesin integruar të vendit me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e integritimit evropian;
- Duke theksuar synimin për forcimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarive të organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integritimit evropian;

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

1. Vlerëson Raportin e Komisionit Evropian të datës 29.05.2019 dhe rekomandimet e tij për reformat e mëtejshme në kuadër të procesit të integritimit evropian;
2. Vlerëson rolin e tij në drejtim të zhvillimit të dialogut gjithëpërfshirës, mbështetur në parimet demokratike, brenda kuadrit kushtetues dhe institucional mbi çështjet e integritimit evropian;
3. Inkurajon forcimin e mëtejshëm të rolit të tij në mbikqyrje të reformave integruese te vendit;
4. Thekson se angazhimi i qëndrueshëm institucional për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe zbatimin e përfundimeve të Këshillit Evropian përbën përparësinë kryesore të punës së Kuvendit të Shqipërisë;
5. Mbështet fort reformën në Drejtësi dhe angazhohet të bashkëpunojë dhe të nxisë institucionet përgjegjëse, me qëllim ngritjen dhe funksionimin e Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit (SPAK), Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) dhe plotësimin e vendeve të lira në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë si dhe zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, brenda vitit 2019;
6. Kërkon nga organet ligjzbatuese, rezultate konkrete dhe të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, si dhe në respektim dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve;
7. Shpreh vullnetin e plotë për forcimin e frymës së mirëkuptimit ndërpartiak dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile në rrugën e thellimit të reformave të ndërmarra në kuadër të procesit të anëtarësimit;

8. Shpreh gatishmërinë e plotë për kryerjen e një reforme terësore dhe gjithëpërfshirëse zgjedhore brenda mandatit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën zgjedhore sipas parimeve demokratike dhe standarteve ndërkombëtare, në interes të qytetarëve shqiptarë;

9. Shpreh angazhimin e plotë dhe i kërkon Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të pavarura zbatimin e përparësive të vendosura nga Komisioni Evropian, me fokus sundimin e së drejtës dhe liritë e të drejtat themelore;

10. I kërkon Këshillit të Ministrave që të paraqesë brenda datës 31 Janar 2020 planin e punës, metodologjinë, planifikimin e burimeve njerëzore dhe financiare në mbështetje të procesit të bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;

11. I kërkon vendeve anëtare të Bashkimit Evropian që në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian të datës 17.04.2018, rikonfirmuar në datën 29.05.2019, si dhe përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian, të mbështetura nga Këshilli Evropian, të qershorit 2018, të zyrtarizojnë hapjen e bisedimeve për anëtarësim me Republikën e Shqipërisë.

Miratuar datë 3.10.2019

KRYETARI
GRAMOZ RUÇI

VENDIM²

Nr. 91, datë 09.02.2022

“PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2022–2024”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024 (PKIE 2022–2024), sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet të bashkërendojë dhe të monitorojë zbatimin e PKIE-së 2022–2024 me institucionet përgjegjës për kryesimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE), për çdo kapitull.
3. Institucione përgjegjëse për kryesimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian raportojnë çdo javë pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2022–2024.
4. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet të raportojë, çdo 3 (tre) muaj, në Këshillin e Ministrave dhe te Kryenegociatori për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2022–2024.
5. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të monitorojë përfshirjen, nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në programin buxhetor afatmesëm, të nevojave financiare për zbatimin e përparësive afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara në PKIE 2022–2024.
6. Legjislacioni i BE-së, për masat afatmesme të planifikuara në PKIE 2022–2024, t'i nënshtrohet procedurës së përkthimit dhe miratimit të materialeve të përkthyer, sipas parashikimeve të akteve nënligjore përkatëse.
7. Vendimi nr.90, datë 17.2.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023”, shfuqizohet.
8. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Këshillit të Ministrave, në përbërje të grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, për të cilat në PKIE-në 2022–2024 janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

²<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/02/09/91>

VENDIM

Nr. 422, datë 6.5.2020

PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe në vijim të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRBËRJA E GRUPIT NEGOCIATOR

1. Grupi Negociator, përgjegjës për zhvillimin e procesit teknik të negociatave të aderimit me institucionet e Bashkimit Evropian, i ngritur me vendimin nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, në kryerjen e detyrave të parashikuara në pikën 3, të kreut V, të vendimit të sipërpërmendur, përbëhet nga:

- Z. Zef Mazi, Kryenegociator;
- Znj. Fjoralba Caka, zëvendësministër i Drejtësisë, negociator përgjegjës për kriteret politike dhe kapitullin 23 të legjislacionit të Bashkimit Evropian;
- Znj. Romina Kuko, zëvendësministër i Brendshëm, negociator përgjegjës për kapitullin 24;
- Z. Sokol Dedja, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, negociator përgjegjës për kapitujt 22 dhe 31 të legjislacionit të Bashkimit Evropian;
- Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kriteret ekonomike dhe kapitullin 33;
- Znj. Belinda Ikonomi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 1, 3, 7, 20, 28 dhe 30;
- Znj. Dajna Sorensen, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator për kapitujt 2 dhe 19;
- Znj. Vasilika Vjero, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator për kapitujt 6, 16, 29 dhe 32;
- Z. Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, negociator për kapitujt 10, 14, 15 dhe 21; - Znj. Ermira Gjeçi, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitujt 11 dhe 12;

- Z. Roland Kristo, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitullin 13;
- Z. Oltion Rrumbullaku, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, negociator për kapitullin 25;
- Znj. Nina Guga, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, negociator për kapitullin 26;
- Znj. Ornela Çuçi, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, negociator për kapitullin 27;
- Znj. Natasha Ahmetaj, zëvendësguvernator i dytë në Bankën e Shqipërisë, negociator për kapitujt 4 dhe 17;
- Znj. Reida Kashta, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik, negociator për kapitullin 5;
- Znj. Juliana Latifi, kryetar i Autoritetit të Konkurrencës, negociator për kapitullin 5;
- Z. Ervin Mete, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, negociator për kapitullin 9;
- Znj. Elsa Dhuli, INSTAT, negociatore për kapitullin 18.

2. Grupi Negociator mbështet punën e Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Delegacionit Shtetëror sipas parashikimeve të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

3. Anëtarët e Grupit Negociator veprojnë për të përmbushur përgjegjësitë që lidhen me procesin teknik të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian, me të cilat i ngarkon vendimi nr.749, datë 19.12.2018, i Këshillit të Ministrave.

4. Çdo anëtar i Grupit Negociator paraqet të paktën çdo tre muaj te Kryenegociatori apo me kërkesë të tij në një afat tjetër një raport mbi ecurinë e negociatave në kapitujt, për të cilët është përgjegjës, me të gjitha informacionet e nevojshme mbi veprimtaritë e anëtarit përgjegjës dhe mbi aktivitetet që lidhen me kapitullin.

5. Pas çdo takimi të Konferencës Ndërqeveritare midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, Grupi Negociator përgatit një raport mbi ecurinë e negociatave i cili i paraqitet nga Kryenegociatori Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Këshillit të Ministrave. Me kërkesë të Këshillit të Ministrave, anëtarët e ekipit negociator përgatisin dhe paraqesin raporte të veçanta, sipas kërkesës. Hartimi i raporteve të tilla bashkërendohet dhe paraqitet në Këshillin e Ministrave nga Kryenegociatori.

6. Anëtarët e Grupit Negociator bashkëkryesojnë nënkomitetet e stabilizimit dhe asociimit, Bashkimi Evropian – Shqipëri, si më poshtë vijon:

- a) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Drejtësia, liria dhe siguria” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitullin 23;
- b) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 1, 3, 7, 20, 28 dhe 30;

- c) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Transporti, mjedisi, energjia dhe zhvillimi rajonal” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 10, 14, 15 dhe 21;
- ç) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Tregtia, industria, doganat dhe tatimet” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 6, 16, 29 dhe 32;
- d) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Për inovacionin, shoqërinë e informacionit dhe politikat sociale” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 10, 14, 15 dhe 21;
- dh) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Çështjet ekonomike, financiare dhe statistikat” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 6, 16, 29 dhe 32;
- e) Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, “Bujqësia dhe peshkimi” bashkëkryesohet nga negociatori përgjegjës për kapitujt 11 dhe 12.

7. Anëtarët e Grupit Negociator, në bashkërendim me Kryenegociatorin, me qëllim garantimin e prioriteteve të kapitujve specifikë gjatë hartimit të programimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për sektorët, për të cilët janë përgjegjës, marrin pjesë në procesin e identifikimit të prioriteteve për mbështetje. Institucioni përgjegjës për secilin nga kapitujt e negociatave siguron zbatimin e parashikimeve të kësaj pike.

8. Sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, të përcaktuar në këtë vendim, anëtarët e Grupit Negociator janë anëtarë me të drejta të plota të Komitetit përkatës Sektorial të Monitorimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian.

9. Grupi Negociator mbe shtetet në funksionet e tij nga Sekretariati i Integritimit Evropian, sic përcaktohet në kreun VII, të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

II. KRYENEGOCIATORI

1. Kryenegociatori barazohet me ministrin e shtetit dhe, në zbatim të parashikimeve të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, ka përgjegjësi për kryerjen e negociatave teknike të anëtarësimit në BE për të gjithë kapitujt negociues. Në veçanti, Kryenegociatori ka këto detyra:

- a) Drejton punën e Grupit Negociator;
- b) Udhëzon Sekretariatit e Integritimit Evropian në zbatimin e detyrave perkatëse;
- c) Siguron unitetin e veprimit të Grupit Negociator duke bashkërenduar punën e tij;
- ç) Përfaqëson Grupin Negociator duke nënshkruar dhe duke përcjellë aktet e vendimit e tij;
- d) Thërret takimet apo mbledhjet e Grupit Negociator dhe drejton diskutimin e anëtarëve të tij sipas agjendës së hartuar paraprakisht;
- dh) Vendos për mundësinë e hapjes për publikun të mbledhjeve të Grupit Negociator;
- e) Emëron një anëtar të Grupit Negociator si drejtues të një çështjeje specifike të negociatave, nëse kjo çështje trajtohet në më shumë se një kapitull të acquis të BE-së ose nëse më shumë se një anëtar i Grupit Negociator merret me të njëjtën temë;

- ë) Përcjell vendimet e Grupit Negociator, që kanë të bëjnë me një kapitull të veçantë të acquis të BE-së, te kryesuesi dhe anëtarët e grupit përgjegjës ndërinstitucional të punës, së bashku me procesverbalin e mbledhjes së Grupit Negociator;
- f) I propozon Grupit Negociator metodologjinë dhe afatet për përgatitjen e qëndrimit negociues për çdo kapitull nga grupi ndërinstitucional i punës, përgjegjës për kapitullin, pas një vlerësimi të plotë dhe analizës së raportit të shqyrtimit (screening) të Komisionit Evropian;
- g) Paraqet pranë Bashkimit Evropian, përmes Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, qëndrimin negociues për çdo kapitull dhe çdo dokument tjetër mbështetës, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, në vijim të marrjes së opinionit nga Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian dhe shqyrtimit nga Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian;
- gj) Informon institucionet e Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare të BE-së lidhur me pikëpamjet e Shqipërisë për çështjet që lidhen me negociatat e anëtarësimit, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe misioneve diplomatike të Republikës së Shqipërisë;
- h) Përcjell, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, udhëzimet e Grupit Negociator për misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë;
- i) I përcjell Grupit Negociator të gjitha informacionet përkatëse nga institucionet e Bashkimit Evropian, shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e tjera kandidate të BE-së;
- j) Përcjell pranë shteteve të BE-së, institucioneve të BE-së dhe vendeve të tjera kandidate, përmes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, kërkesat e Grupit Negociator për informacion dhe mendime lidhur me hartimin e qëndrimeve negociuese dhe çdo kërkesë tjetër të Grupit Negociator për informacion të nevojshëm në lidhje me një kapitull të veçantë apo me procesin e negociatave;
- k) Miraton kërkesat e Grupit Negociator në lidhje me angazhimin profesional të organizatave profesionale apo çdo subjekti të ndryshëm nga anëtarët e Grupit Negociator dhe kryen angazhimin e ekspertëve të fushave të ndryshme për të mbështetur kryerjen e detyrave të tij apo të detyrave dhe nevojave të grupit negociator për çështje të veçanta komplekse, pasi të ketë marrë miratimin e kryetarit të Delegacionit Shtetëror apo të personit të autorizuar prej tij. Nëse një veprim i tillë kërkon alokim fondesh shtesë, Kryenegociatori, pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për financat, paraqet përmes ministrit përgjegjës për Evropën kërkesën pranë Këshillit të Ministrave;
- l) I paraqet, të paktën çdo tre muaj, Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian dhe Këshillit të Ministrave një raport të konsoliduar mbi përparimin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, bazuar në raportet tremujore të anëtarëve të Grupit Negociator sipas pikës 3, të kreut I, të këtij vendimi;
- ll) Bashkëkryeson Komitetin e Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri dhe është pjesë e delegacionit shqiptar në Këshillin e Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri;
- m) Merr pjesë në cilësinë e zëvendëskryetarit në Delegacionin Shtetëror dhe në cilësinë e anëtarit në Komitetin Shtetëror për Integrimin Evropian;
- n) Harton një udhëzim kuadër të koordinimit të punës së Sekretariatit të Integrimin Evropian, i cili është pjesë përbërëse e rregullave të funksionimit të Sekretariatit, që miratohet me

urdhër të ministrit përgjegjës për Evropën, sipas parashikimeve të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

nj) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së Grupit Negociator dhe kryerjen e detyrave përkatëse pas marrjes së miratimit nga kryetari i Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian;

o) Çdo detyrë dhe funksion të parashikuar në vendimin nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

2. Kryenegociatori është Koordinatori Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian dhe siguron pjesëmarrjen e anëtarëve të Grupit Negociator në programimin dhe monitorimin e asistencës financiare të BE-së në kapitujt, për të cilët ata janë përgjegjës.

3. Kryenegociatori merr pjese rregullisht, pa te drejte vote, ne mbledhjet e Ke shillit te Ministrave.

4. Në rastet e mungesave, të pamundësisë apo të paaftësisë fizike për të vepruar të Kryenegociatorit, detyrat e përcaktuara në këtë kre kryhen nga zëvendëskryenegociatori, i cili përcaktohet me akt të veçantë të Kryenegociatorit nga radhët e negociatorëve. Zëvendëskryenegociatori kryen dhe detyra të tjera me kërkesë të Kryenegociatorit.

III. KABINETI I KRYENEGOCIATORIT

1. Kabineti i Kryenegociatorit funksionon pranë Kryeministrit dhe në Misionin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Struktura dhe funksionimi i tij miratohen me urdhër të Kryeministrit.

2. Kabineti në koordinim me njësinë përgjegjëse për nismat ligjore prioritare dhe acquis në Kryeministri dhe Sekretariatit e Integritimit Evropian i siguron Kryenegociatorit ndihmën e duhur teknike dhe asistencën administrative për të mbështetur zbatimin e detyrave të tij.

3. Funkionarët e kabinetit të Kryenegociatorit emërohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të Kryenegociatorit.

IV. RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË GRUPIT NEGOCIATOR

1. Projektpropozimet për qëndrimet negociuese, të hartuara nga grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të acquis, shqyrtohen nga anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin. Anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin, propozon qëndrimin e Grupit Negociator për projektpropozimet për qëndrimet negociuese para se ato t'i përcillen Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian, sipas vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

2. Vlerësimi analitik i harmonizimit të legjislacionit vendas me acquis, i përgatitur sipas vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, nga grupi ndërinstitucional i punës për integrimin evropian për çdo kapitull shqyrtohet nga anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin.

3. Anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin, propozon qëndrimin e Grupit Negociator për vlerësimin analitik para se Grupi Negociator të vendosë formën përfundimtare të vlerësimit analitik që do t'i paraqitet Komisionit Evropian.
4. Takimet e Grupit Negociator thirren nga Kryenegociatori dhe mbahen të paktën një herë në muaj. Një ftesë me shkrim u dërgohet anëtarëve të Grupit Negociator të paktën pesë ditë para takimit. Projektrendi i ditës së mbledhjes, procesverbali i mbledhjes së mëparshme dhe materialet e tjera të rëndësishme do t'u dorëzohen anëtarëve të Grupit Negociator së bashku me ftesën me shkrim.
5. Pjesëmarrja në takime është e detyrueshme. Në rast të pamundësisë për të marrë pjesë, anëtari i Grupit Negociator informon Kryenegociatorin përpara datës së takimit dhe cakton një përfaqësues zëvendësues për të marrë pjesë në takim.
6. Takimet e Grupit Negociator kryesohen nga Kryenegociatori dhe konsiderohen të vlefshme vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në fillim të çdo mbledhjeje miratohet procesverbali i mbledhjes së mëparshme. Anëtarët e Grupit Negociator kanë të drejtë të bëjnë komente me shkrim para mbledhjes ose gojarisht gjatë takimit. Pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes së mëparshme dhe me propozimin e Kryenegociatorit, miratohet rendi i ditës i mbledhjes. Në raste të justifikuara dhe urgjente, me propozimin e Kryenegociatorit ose të një anëtari të Grupit Negociator, rendi i ditës së mbledhjes mund të ndryshohet dhe të plotësohet me materiale ose dokumente që nuk ishin përfshirë fillimisht. Ndryshimet në rendin e ditës kërkojnë miratimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm të Grupit Negociator.
7. Nëse është e nevojshme, me ftesë të Kryenegociatorit, në mbledhjet e Grupit Negociator mund të marrin pjesë edhe ekspertë që nuk janë anëtarë të Grupit Negociator. Ekspertët marrin pjesë në diskutim pa të drejtë vote.
8. Informacioni dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi Negociator mund të jenë të disponueshme për publikun, me vendim të Kryenegociatorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Udhëzimet në lidhje me deklaratat publike ose paraqitjen publike të një anëtari të Grupit Negociator jepen nga Kryenegociatori.
9. Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit Negociator kanë të drejtën e aksesit në informacionin e klasifikuar në lidhje me fushën e përgjegjësisë së tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës.
10. Qëndrimet e Grupit Negociator miratohen me votim. Votimi është i hapur. Një vendim konsiderohet i miratuar nëse merr shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm të Grupit Negociator.
11. Procesverbali i takimit të Grupit Negociator përgatitet nga Sekretariati i Integritetit Evropian. Drafti i procesverbalit të mbledhjes u komunikohet në mënyrë elektronike anëtarëve të Grupit Negociator jo më vonë se një javë pas mbledhjes. Takimet e Grupit Negociator mund të regjistrohen. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryenegociatori.

12. Në mbledhjen e parë të Grupit Negociator miratohet rregullorja e brendshme e funksionimit.

V. TRAJTIMI FINANCIAR

1. Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit Negociator, përveç pagës së tyre mujore, përfitojnë dhe shpërblim për rezultatet, sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

2. Subjektet joanëtare të Grupit Negociator mund të përfitojnë, sipas angazhimit të tyre dhe detyrave specifike të akorduara nga Kryenegociatori, një pagesë në përputhje me përcaktimet e vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

3. Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve të Grupit Negociator do të mbulohen nga autoritetet shtetërore dhe organet e administratës shtetërore në të cilat janë punësuar anëtarët e Grupit Negociator, në përputhje me legjislacionin që rregullon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive e të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit.

4. Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve të Grupit Negociator, të cilët nuk janë të punësuar nga autoritetet shtetërore dhe organet e administratës shtetërore, do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për Evropën, në përputhje me legjislacionin që rregullon mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive e të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit.

5. Urdhrat e udhëtimit për Kryenegociatorin miratohen nga Kryeministri apo një person i autorizuar prej tij.

6. Udhëtimet për shërbim jashtë shtetit për anëtarët e Grupit Negociator propozohen për miratim nga Kryenegociatori tek autoriteti shtetëror që mbulon shpenzimet përkatëse.

7. Kryenegociatori dhe anëtarët e Grupit Negociator i paraqesin raport me shkrim Kryetarit të Delegacionit Shtetëror, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda 7 (shtatë) ditëve nga përfundimi i udhëtimit të punës.

VI. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kryenegociatori dhe kabineti i tij ndihmës të shtohen si njësi organizative e veçantë në strukturën e Kryeministrisë.

2. Rregullimet lidhur me burimet njerëzore dhe ato financiare për Grupin Negociator do të bëhen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike, anëtarët e Grupit Negociator dhe institucionet e përmendura në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 421, datë 27.5.2020³

PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS PËR ANËTARËT DHE SUBJEKTET JOANËTARE TË GRUPIT NEGOCIATOR PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN, SI DHE TË FUNKSIONARËVE TË KABINETIT TË KRYENEGOCIATORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen, si më poshtë vijon:
 - a) Kryenegociatori;
 - b) Funkionarët e kabinetit të Kryenegociatorit;
 - c) Subjektet joanëtare të grupit negociator.
2. Nivelet e pagave për Kryenegociatorin dhe funksionarët e kabinetit të tij janë, si më poshtë vijon:
 1. Kryenegociatori barazohet në pagë me ministrin;
 2. Drejtori i kabinetit të Kryenegociatorit barazohet në pagë me pozicionin “drejtor i kabinetit të ministrit”;
 3. Këshilltari në kabinetin e Kryenegociatorit barazohet në pagë me pozicionin “këshilltar i ministrit”;
 4. Sekretari i Kryenegociatorit barazohet në pagë me pozicionin “sekretar i ministrit”.
3. Subjektet joanëtare të grupit negociator, të cilët kryejnë detyra të ngarkuara nga Kryenegociatori, përfitojnë një pagesë në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë për çdo ditë pune, e cila paguhet pas realizimit të punës së ngarkuar.
4. Për përfitimin e pagesës së përcaktuar sipas pikës 3, të këtij vendimi, subjekti joanëtar i grupitnegociator i bashkëlidh raportit të tij për punën e kryer formularin e kohëzgjatjes së punës, të hartuar në përputhje me lidhjen nr.13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Formulari i kohëzgjatjes së punës miratohet nga Kryenegociatori.
5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2020, të përballohen nga buxheti i miratuar për Kryeministrinë për këtë vit.
6. Ngarkohet Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

³ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/98/9627cbf1-a528-4e11-8a6a-597b16cfaae2>

REZOLUTË E KUVENDIT

Datë 24.09.2020

PËR HAPJEN E NEGOCIATAVE PËR ANËTARËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN DHE PLANIN E MASAVE PËR PËRMBUSHJEN E PËRPARËSIVE TË PËRCAKTUARA NGA KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN

Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian” dhe të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

- Duke marrë parasysh vendimin e Këshillit të Bashkimit Europian të datës 25 mars 2020 për hapjen e negociatave për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë bazuar në progresin e arritur në reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara me unanimitet nga Këshilli i Bashkimit Europian;

- Duke theksuar rolin parësor të Kuvendit në kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore për integrimin europian në përmbushjen e detyrimeve të procesit të integrimit dhe duke shërbyer si urë lidhëse midis aktorëve të përfshirë;

- Duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi Europian dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave të ndërmarra për konsolidimin e shtetit të së drejtës, forcimin e institucioneve demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

- Duke vlerësuar miratimin nga Këshilli i Bashkimit Europian të Metodologjisë së re të Negociatave, që do t'i japë procesit më shumë dinamizëm, besueshmëri, parashikueshmëri dhe vullnet më të fortë politik;

- Duke marrë parasysh projektin e Kornizës së Negociimit me Republikën e Shqipërisë, që përcakton parimet dhe procedurat sipas të cilave do të zhvillohen negociatat e anëtarësimit, paraqitur nga Komisioni Europian në datën 1 korrik 2020;

- Duke marrë parasysh vendimin e Këshillit të Bashkimit Europian që konferenca e parë ndërqeveritare të mbahet sa më shpejt pas miratimit të Kornizës së Negociimit nga Këshilli dhe deri atëherë Shqipëria duhet të ketë miratuar reformën zgjedhore në përputhje me rekomandimet e OSBE- ODIHR-it, duke siguruar vijimësinë e rritjes së standardeve ndërkombëtare të dakordësuara dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar financim transparent të partive politike dhe fushatave elektorale; të ketë siguruar vijimin e zbatimit të reformës në drejtësi, përfshirë funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën ndërkombëtare, përfshirë opinionet përkatëse të Komisionit të Venecias; të ketë përfunduar ngritjen e strukturave të specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; të ketë forcuar më tej luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe përmes planveprimit për të adresuar rekomandimet e Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF); - Duke u bazuar në përparësitë që duhet të përmbajë Korniza e Negociimit, që do t'i paraqitet Shqipërisë në

konferencën e parë ndërqeveritare, të përcaktuara nga Këshilli i Bashkimit European më 25 mars 2020, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

1. Përshëndet vendimin historik të Bashkimit European për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë.
2. Vlerëson progresin e arritur në reformat që lidhen me integrimin europian, të cilat mundësuan plotësimin e kushteve për hapjen e negociatave të anëtarësimit dhe vendimin përkatës të Këshillit të Bashkimit European.
3. Rikonfirmon se procesi i negociatave dhe anëtarësimi me të drejta të plota në Bashkimin European është objektivi madhor i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kryeson axhendën e saj kombëtare, si një vend që synon dhe është i angazhuar plotësisht për konsolidimin e demokracisë, respektimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe minoriteteve, të dialogut politik, të transparencës, të gjithëpërfshirjes dhe të ekonomisë funksionale të tregut, që përbëjnë vlerat e përbashkëta mbi të cilat është themeluar Bashkimi European.
4. Rikonfirmon qasjen e tij se përparimi në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European të Shqipërisë bazohet në hartimin dhe zbatimin plotësisht të reformave transformuese dhe të pakthyeshme.
5. Thekson se dialogu konstruktiv politik brenda kuadrit institucional kushtetues është thelbësor për konsolidimin e demokracisë funksionale dhe për procesin e anëtarësimit në Bashkimin European.
6. Mori dijeni për Planin e Veprimit për plotësimin e përparësive të përcaktuara në përfundimet e Këshillit të Bashkimit European të 25 marsit 2020.
7. U kërkon qeverisë dhe të gjitha institucioneve të tjera përgjegjëse që të konsolidojnë reformat e arritura dhe të thellojnë më tej reformat për plotësimin e përparësive të vendosura në përfundimet e Këshillit të Bashkimit European të datës 25 mars 2020.
8. I kërkon qeverisë që të koordinojë institucionet përgjegjëse dhe ato të raportojnë në Kuvend një herë në tre muaj për zbatimin e këtij Plani Veprimi.
9. Inkurajon zyrën e Kryenegociatorit të vijojë bashkëpunimin ndërinstitutional, me qëllim paraqitjen objektive në institucionet europiane dhe vendet anëtare të Bashkimit European të arritjeve dhe përparimin e reformave të realizuara.
10. Angazhohet që të monitorojë zbatimin e Planit të Veprimit duke forcuar më tej veprimtarinë e organeve nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, si Komisioni për Integrimin European dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin European, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në këtë proces.
11. Angazhohet që të bashkëveprojë dhe të monitorojë me përgjegjësi të lartë të gjitha institucionet e përfshira, të cilat kanë për detyrë të marrin masat për trajtimin me përparësi të të gjitha kushteve, si: zbatimin e reformës zgjedhore në përputhje me rekomandimet e

OSBE/ODIHR-it, duke siguruar financim transparent të partive politike dhe fushatave elektorale; sigurimin në vazhdimësi të zbatimit të reformës në drejtësi, përfshirë funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën ndërkombëtare, përfshirë opinionet përkatëse të Komisionit të Venecias; përfundimin e ngritjes së strukturave të specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; forcimin më tej të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe përmes planveprimit për të adresuar rekomandimet e TaskForcës së Veprimit Financiar (FATF), si dhe amendimin e ligjit të medias sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

12. Angazhohet të garantojë dhe të fuqizojë integritetin dhe pavarësinë e institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

13. Angazhohet të forcojë ndërveprimin dhe veprimtarinë diplomatike me parlamentet e vendeve anëtare të Bashkimit European, në funksion të njohjes më të mirë të zbatimit të reformave nga ana e vendeve anëtare dhe opinionit të tyre publik.

14. Angazhohet të vazhdojë të shqyrtojë me përparësi dhe në një proces të gjerë konsultimi kuadrin ligjor, që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European, si dhe të gjitha nismat të cilat janë pjesë e axhendës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me Kushtetutën dhe konventat ndërkombëtare.

15. U bën thirrje shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe të gjithë aktorëve shoqërorë të përfshihen në mënyrë përmbajtjesore në diskutimet e Këshillit Kombëtar të Integritimit European dhe në platformat e tjera, në funksion të mirinformimit për këtë proces me përparësi madhore në interes të vendit.

16. Mbi bazën e arritjeve në zbatimin e përparësive kyçe të Planit të Veprimit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë inkurajon Bashkimin European dhe vendet anëtare të tij në marrjen e vendimit për mbajtjen e Konferencës së parë Ndërqeveritare sa më shpejt brenda vitit 2020.

Miratuar në datën 24.9.2020

KRYETARI
GRAMOZ RUÇI

VENDIM

Nr.91, datë 9.2.2022⁴

“PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2022–2024”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024 (PKIE 2022–2024), sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet të bashkërendojë dhe të monitorojë zbatimin e KIE-së 2022–2024 me institucionet përgjegjëse për kryesimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE), për çdo kapitull.
3. Institucionet përgjegjëse për kryesimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian raportojnë çdo javë pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2022–2024.
4. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet të raportojë, çdo 3 (tre) muaj, në Këshillin e Ministrave dhe te Kryenegociatori për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2022–2024.
5. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të monitorojë përfshirjen, nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në programin buxhetor afatmesëm, të nevojave financiare për zbatimin e përparësive afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara në PKIE 2022–2024.
6. Legjislacioni i BE-së, për masat afatmesme të planifikuara në PKIE 2022–2024, t'i nënshtrohet procedurës së përkthimit dhe miratimit të materialeve të përkthyer, sipas parashikimeve të akteve nënligjore përkatëse.
7. Vendimi nr.90, datë 17.2.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023”, shfuqizohet.
8. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Këshillit të Ministrave, në përbërje të grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, për të cilat në PKIE-në 2022–2024 janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

⁴ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/27/a4c35fa5-7abf-49b6-a508-aa4188dd002f>

VENDIM Nr. 520, datë 29.7.2022⁵

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe në vijim të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, të kreut I, bëhen këto ndryshime:

i. Fjalët “z. Zef Mazi, Kryenegociator;” zëvendësohen me “znj. Majlinda Dhuka, ministër Shteti dhe Kryenegociator (në vijim “Kryenegociatori)”;

ii. Fjalët “znj. Juliana Latifi” zëvendësohen me “z. Denar Biba”.

b) Në kreun II bëhen këto ndryshime:

i. Në fjalinë e parë, të pikës 1, hiqen fjalët “... barazohet me ministrin e shtetit dhe;”;

ii. Në fjalinë e dytë, të shkronjës “k”, të pikës 1, hiqen fjalët “..përmes ministrit përgjegjës për Evropën dhe punët e jashtme ...”;

iii. Pika 3 shfuqizohet.

c) Në kreun V bëhen këto ndryshime:

i. Pika 5 shfuqizohet;

ii. Në pikën 7 hiqen fjalët “... Kryenegociatori dhe ...”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit dhe Kryenegociator dhe grupi negociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

⁵ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/110/ede7a787-0554-475a-8558-58d8b52016fd>

